



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Gazetari”

ofruar nga

**Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti i Elbasanit
Aleksandër Xhuvani”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof.Asoc.Dr. Ramadan Çipuri

2. Prof.Asoc.Dr. Holta Heba

Mars 2023

Për Programin e studimit Bachelor në "Gazetari" ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë "Universiteti i Elbasanit Aleksandë Xhuvani"

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti Aleksandër Xhuvani
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Letërsisë dhe Gazetarisë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në Gazetari
4	Urdhëri/VKM i licencin.it:	Urdhër nr.4709 prot, Datë. 19.07.2004
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër nr.266, dt.10.08.2009
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	I parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	6 (gjashtë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	Total 23 PAE 15 /PAK 8
18	Numri i studentëve:	2019-2020 14 studentë 2020-2021 10 studentë 2021-2022 8 studentë
19	Komente / të tjera:	-

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM


Programi i studimit “Bachelor në Gazetari” ofrohet nga Departamenti i Letërsisë dhe Gazetarisë, pranë Fakultetit të Shkencave Humane në Universitetin “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan. Ky program studimi u hap fillimisht në vitin 2004, brenda strukturës së Fakultetit të Shkencave Sociale, i ndryshuar më vonë në Fakultetin e Shkencave të Edukimit. Pas ndryshimeve në riorganizimin e brendshëm të institucionit, nga viti 2008, pranë Fakultetit të Shkencave Humane u krijua seksioni i Gazetarisë, si pjesë e Departamentit Gjuhë, Letërsi dhe Gazetari. Në vitin 2012 ky departament u nda në dy njësi bazë. Nga kjo datë, njësi bazë përgjegjëse për ofrimin e këtij programi studimi është Departamenti i Letërsisë dhe Gazetarisë.

Varësisht reformës së arsimit të lartë në Shqipëri, sipas Procesit të Bolonjës, ky program studimi është ndryshuar në përputhje me kriteret e reja. Diploma që ofronte më parë “Diplomë e nivelit të parë në gazetari” u riemërtua në “Bachelor në Gazetari”.

Kohëzgjatja e programit është 3 vite akademike, të ndarë në 6 semestra, me 180 kredite (ECTS), përkatësisht me 60 kredite/vit dhe 1500 orë në vit. Nga viti 2004 deri në vitin akademik 2019-2020 në këtë program studimi janë diplomuar 576 studentë.

Në tërësinë e tij, programi synon të japë njohuritë bazë për gazetarinë, shkencat e komunikimit dhe fusha të ndryshme të përcjelljes së informacionit me anë të mjeteve të ndryshme, për t’u mundësuar studentëve ndërtimin e një karriere profesionale, jo vetëm në sektorin publik, por edhe atë privat. Në këtë gamë njohurish ka edhe njohuri plotësuese për ato fusha që ndihmojnë dhe japin mundësi zhvillimi të mëtejshëm në drejtime të tjera studimi, të cilat janë të lidhura ngushtësisht me natyrën e komunikimit.

Varësisht numrit të madh të profesioneve që lidhen me komunikimin, programi “Bachelor në Gazetari” është organizuar në mënyrë të tillë, që të ofrojë mundësi punësimi për studentët e diplomuar kryesisht si gazetarë, specialistë në industrië e informimit, specialist në zyrat e marrëdhënieve publike, në administrimin e mediave, në komunikimin e integruar, etj.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm i programit të studimit “Bachelor në Gazetari” nisi punën për vlerësimin duke u njohur fillimisht me materialet dokumentare të vendosur në sistemin e ASCAL. Koordinator i programit ndau përmes platformës dokumentet e nevojshme thuajse për të gjitha pikat që vlerësohen në program, me një numër të zgjeruar evidencash.

Përfaqësuesja e ASCAL në këtë program studimi është znj. Endra Velaj.

Nën koordinimin e ekspertes së caktuar nga ASCAL, u planifikua vizita në institucion në datën 5 dhjetor 2022. Gjatë vizitës u realizuan takimet me Dekanin e Fakultetit të Shkencave Humane, me Përgjegjësin e Departamentit të Letërsisë dhe Gazetarisë, me Grupin e Vlerësimit të Brendshëm të raportit të paraqitur, me pedagogë të Departamentit të Letërsisë dhe Gazetarisë, studentë nga ky program, përfaqësues të Drejtorisë së Kurrikulave dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe Këshillimit të Karrierës, Alumni; përfaqësues të Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, përfaqësues të Drejtorisë së Koordinimit dhe Marrdhënieve me Jashtë, përfaqësues të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore. Më tej, u zhvillua një vizitë në sekretarinë mësimore, u vëzhguan mjediset në funksion të këtij programi (auditorë, laboratorë, shërbimet për studentë, etj.), u vizitua biblioteka, ku u panë nga afër mundësitë që ofron ajo për studentët e këtij programi studimi.

Gjatë vizitës u kërkuar informacion shtesë i cili u plotësua dhe u vendos në faqen e ASCAL.

Duhet theksuar fakti se, i gjithë stafi me të cilin zhvilluam takimet ishin të gatshëm për t’iu përgjigjur pyetjeve të lindura gjatë procesit të hulumtimit të dokumentacionit të paraqitur, si edhe dorëzimit në kohë të evidencave shtesë të kërkuara gjatë vizitës në institucion.


Me datë 19/01/2023, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 2/18 Prot., Datë 20/01/2023, dërgohet në Institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL përcolli komentet përmes AMS me datë 07/03/2023 dhe me shkresë zyrtare Nr. 228/9 Prot., Datë 06/03/2023. Institucioni vlerëson punën e GVJ dhe shprehet se nuk ka hapsirë për komente lidhur me Draft-Raportin e këtij programi studimi.

Në këtë mënyre, Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm merr formën e tij finale e përfundimtare.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Gazetari”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Standardi I.1 Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</p> <p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.</p>	<p>Pas një vlerësimi të detajuar të raportit të vlerësimit të brendshëm, por edhe evidencave të paraqitura që tregojnë mënyrën e organizimit institucional, vizionin dhe misionin e Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” (UNIAL), të shprehura qartë në Statutin e këtij institucioni, Strategjinë së Zhvillimit Institucional 2020-2024, Planin e Zhvillimit Strategjik 2016-2020, Strategjinë e Zhvillimit të Fakultetit të Shkencave Humane dhe Strategjinë e zhvillimit të Departamentit të letërsisë dhe gazetarisë, rezulton se UNIEL ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.</p> <p><i>Evidenca: 1.1 Statuti i Universitetit “A. Xhuvani”;</i> <i>Evidenca 1.3 Strategjia e UNIEL;</i> <i>Evidenca 1.16 Strategjia e zhvillimit të Fakultetit të Shkencave Humane;</i> <i>Evidenca 1.17 Strategjia e zhvillimit të departamentit të letërsisë dhe gazetarisë</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Mbështetur në evidencat e dokumentuara nga Institucioni, konkretisht Statuti, Rregullorja e studimeve, Strategjia e zhvillimit të UNIEL, Strategjia e zhvillimit të FSHH, Strategjia e zhvillimit të Letërsisë dhe Gazetarisë, si edhe në Kornizën konceptuale të programit të studimit “Bachelor në Gazetari”, vihet re se ky program studimi është hartuar me kujdes në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë së tij.</p> <p><i>Evidenca 1.1. Statuti i Universitetit “A. Xhuvani”;</i> <i>Evidenca 1.2 Rregullore e studimeve UE;</i> <i>Evidenca 1.3 Strategjia e Zhvillimit të Universitetit të Elbasanit; Evidenca 1.16. Strategjia e Zhvillimit të FSHH-së;</i> <i>Evidenca 1.17. Strategjinë e zhvillimit të departamentit të letërsisë dhe gazetarisë</i> <i>Evidenca 3.14 Korniza konceptuale e programit të studimit “Bachelor në gazetari”</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.</p>	<p>Referuar të njëjtit dokumentacion si në kriteret e mësipërme, por edhe vizitës në institucion dhe takimeve që u zhvilluan me përfaqësues të zyrave të ndryshme, u konstatua se programi i studimit “Bachelor në Gazetari” është hartuar dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.</p> <p><i>Evidenca 1.1. Statuti i Universitetit “A. Xhuvani”;</i> <i>Evidenca 1.3 Strategjia e Zhvillimit të Universitetit të Elbasanit;</i></p>



	<p><i>Evidenca 1.16. Strategjia e Zhvillimit të FSHH-së;</i> <i>Evidenca 1.17. Strategjinë e zhvillimit të departamentit të letërsisë dhe gazetarisë;</i> <i>Evidenca 1.4 Rregullore e Universitetit të Elbasanit;</i> <i>Evidenca 1.7. Rregullore e FSHH-së;</i> <i>Evidenca 1.14. Rregullore e departamentit të letërsisë dhe gazetarisë</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Nga aspekti institucional, UNIAL është ndër të institucionet e arsimit të lartë me një eksperiencë të gjatë në vendin tonë. Ai zotëron përvojë, kapacitete dhe burimet e duhura në fushën akademike.</p> <p>Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga Departamenti i Letërsisë dhe Gazetarisë, por edhe nga verifikimet e bëra gjatë vizitës në institucion, u konstatua se trupa akademike përbëhet nga një staf i kualifikuar, që përmbush detyrimet ligjore në raport me titujt akademik dhe gradat shkencore.</p> <p>Departamenti ka angazhuar në mësimdhënie edhe specialistë të fushës së medias, komunikimit dhe marketingut si lektorë me kohë të pjesshme apo asistentë në lëndë të caktuara.</p> <p><i>Evidenca 1.5 Urdhri i hapjes UNIEL.;</i> <i>Evidenca 1.6 Certifikata e Akreditimit Institucional;</i> <i>Evidenca 3.14 Korniza konceptuale e programit të studimit "Bachelor në gazetari";</i> <i>Tabela 7 - Të dhënat përmbledhëse të stafit akademik për "Bachelor në gazetari", sipas kualifikimit dhe raportet midis tyre;</i> <i>Tabela 19 - Veprimtari shkencore individuale të stafit akademik në funksion edhe të programit të studimit, në vitet e fundit</i></p>
<p>Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Njësi bazë e ofrimit të këtij programi studimor është pjesë e FSHH-së, që ofron programe studimi në fushën e medias, gazetarisë, shkencave të komunikimit, në fushën e studimeve letrare, të historiografisë së letërsisë shqiptare dhe asaj botërore, por edhe albanologjisë apo fushave ndërdisiplinore. Në këtë kontekst, fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit "Bachelor në Gazetari" është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, fakultetit dhe njësisë bazë, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit dhe sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p> <p>Diploma e lëshuar nga ky program studimi i përket nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK), ciklit të parë të studimeve universitare me numrin unik të identifikimit 000090 në regjistrin e diplomave të regjistruara në Ministrinë e Arsimit në Republikën e Shqipërisë.</p> <p><i>Evidenca 1.27 Shkresa e QSHA për miratimin e formatit të diplomës së programit të studimit. Modeli i diplomës të programit të studimit "Bachelor në gazetari";</i> <i>Evidenca 1.26 Shkresa e QSHA për Kodin e programit të studimit;</i> <i>Evidenca 1.28 Shkresa e QSHA për regjistrimin e diplomës së programit të studimit "Bachelor në gazetari".</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Mbështetur në evidencat e paraqitura në dosje, por edhe në vizitën e zhvilluar në institucion, rezulton se UNIEL ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. Vetë programi i studimit</i></p>

	<p><i>“Bachelor në Gazetari” është hartuar dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, fushën e veprimtarisë së tij, dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së UNIAL, si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij. UNIEL, njësia kryesore dhe njësia bazë që ofrojnë këtë program studimi kanë përvojën dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi të gazetarisë. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit “Bachelor në Gazetari” përputhet me fushën akademike e kërkimore të Fakultetit të Shkencave Humane, Departamentit të Letërisë dhe Gazetarisë.</i></p> <p><i>Kështu, konstatojmë se kriteret e këtij standardi përmbushen plotësisht.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

Standardi I.2

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njërive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Nga informacioni i mbledhur gjatë vizitës në institucion, por edhe nga evidencat që shoqërojnë raportin e vlerësimit të brendshëm, konkretisht Struktura organizative e UNIEL, Rregullorja e organizimit dhe funksionimit UNIEL, Analiza vjetore institucionale 2020-2021, Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Humane; Rregullorja e programit të studimit “Bachelor në gazetari”; Strategjia e zhvillimit të programit të studimit “Bachelor në gazetari”; Raporti për veprimtarinë e programit të studimit “Bachelor në gazetari” për vitin akademik 2020-2021/ 2021-2022; Analizat e punës vjetore të departamentit të letërisë e gazetarisë 2020-2021/ 2021-2022, rezultojnë se Departamenti i letërisë dhe gazetarisë, në funksion të mbarëvajtjes së punës në drejtim të zbatimit të programit të studimit “Bachelor në Gazetari” bashkëpunon ngushtësisht për mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, edhe me departamente të tjera të FSHH-së (si ai i gjuhësisë, historisë, i gjuhëve të huaja) dhe të njërive të tjera të UNIEL për lëndë të tipologjive të ndryshme që ofrohen në këtë program.</p> <p>Ky bashkërendim vihet re edhe në zyrat e ndryshme të institucionit, të cilat angazhohen me detyrat administrative si burimet njerëzore, sekretaria mësimore, biblioteka, etj.</p> <p><i>Evidenca 1.10 Struktura organizative e UNIEL;</i> <i>Evidenca 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL;</i> <i>Evidenca 1.11 Analiza vjetore institucionale 2020-2021;</i> <i>Evidenca 1.7 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane;</i> <i>Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit “Bachelor në gazetari”;</i> <i>Evidenca 1.18 Strategjia e zhvillimit të programit të studimit “Bachelor në gazetari”;</i></p>

	<p><i>Evidenca 1.29 Raport për veprimtarinë e programit të studimit "Bachelor në gazetari" për vitin akademik 2020-2021/ 2021-2022;</i></p> <p><i>Evidenca 1.32 Analizat e punës vjetore të departamentit të letërsisë e gazetarisë 2020-2021/ 2021-2022.</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave Humane, si njësi kryesore e UNIEL, për realizimin e objektivave të programit të studimit, si dhe procesit mësimor e formues të studentëve, ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj. Përgjithësisht, këto marrëveshje janë realizuar në nivel institucional, prej të cilave përfiton edhe Departamenti i Letërsisë dhe Gazetarisë me të gjithë programet e studimit që ai ofron. Në lidhje me njësinë bazë që ofron këtë program, ka disa marrëveshje që shërbejnë në funksion të realizimit të objektivave të synuara, si p.sh. marrëveshja me Qendrën shqiptare për gazetari cilësore, USAID, universitetet shqiptare brenda dhe jashtë trojeve. Veç tyre, departamenti ruan marrëdhënie të ngushta bashkëpunimi me organizata dhe institute kërkimore në fushën e medias dhe komunikimit.</p> <p><i>Evidenca 1.12 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit;</i></p> <p><i>Evidenca 1.13 Lista e marrëveshjeve për zhvillimin e praktikave;</i></p> <p><i>Evidenca 1.11 Analiza vjetore institucionale 2020-2021;</i></p> <p><i>Evidenca 1.30 Raporti i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimeve;</i></p> <p><i>Evidenca Tabela 5 Lista e institucioneve bashkëpunuese për programin e studimit "Bachelor në Gazetari".</i></p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>UNIAL ka nënshkruar shumë marrëveshje ndër-institucionale, qofshin këto me institucione arsimore, apo edhe aktorë të tregut publik ose privatë, të cilat edhe pse në nivel institucional, shërbejnë për mbarëvajtjen e mirë të programit "Bachelor në Gazetari". Vlen për t'u vlerësuar se ka edhe një numër të konsiderueshëm marrëveshjesh me institucione të ndryshme në rang programi, të cilat vihen në shërbim të studentëve për ushtrimin e praktikave profesionale, kryesisht në vitin e tretë të studimeve, në semestrin e dytë, ku ata njihen me median në formën e praktikës profesionale në terren.</p> <p><i>Evidenca 1.33 Paketa e praktikës për programin e studimit "Bachelor në gazetari";</i></p> <p><i>Evidenca 1.13 Lista e marrëveshjeve për zhvillimin e praktikave;</i></p> <p><i>Evidenca Tabela 5 - Institucionet dhe organizatat bashkëpunuese në rang programi/esh studimi për Praktikën profesionale me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë;</i></p> <p><i>Evidenca 1.8 Rregulloret e programit të studimit "Bachelor në gazetari".</i></p>
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e</p>	<p>Nga verifikimi i evidencave mbi veprimtarinë e programit të studimit "Bachelor në gazetari" për vitin akademik 2020-2021/2021-2022, dhe raportit të fundit periodik analitik të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimeve, por edhe nga takimi i zhvilluar me anëtarë të stafit akademik të këtij programi</p>


Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gimn. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	<p>studimi, u konstatua se njësia bazë, në përfundimin e vitit akademik harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit në fjalë.</p> <p><i>Evidenca 1.29 Raport për veprimtarinë e programit të studimit "Bachelor në gazetari" për vitin akademik 2020-2021/2021-2022;</i> <i>Evidenca 1.30 Raporti i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimeve.</i></p>			
Konkluzione	<p><i>Referuar dokumentacionit të paraqitur në dosje dhe të dhënave të mbledhura nga vizita në institucion u konstatua se ka një bashkëpunim dhe bashkërendim të kënaqshëm të punëve, detyrave dhe ndarjes së përgjegjësisë midis njësisë të ndryshme brenda institucionit në funksion të këtij programi studimi. Gjithashtu, ka një numër të lartë marrëveshjesh bashkëpunimi të realizuara nga UNIEL për partneritete sa në rafshin akademik, por edhe nga njësia bazë, për realizimin e praktikave profesionale të studentëve. Ndërkohë, vihet re një vëmendje e shtuar ndaj vlerësimit analitik të përvitshëm të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</i></p> <p><i>Varësisht këtyre të dhënave, mund të themi se institucioni i përmbush plotësisht kriteret e këtij standardi.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X
---	--	------------------------------	-----------------------------	--



II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR


Standardi II.1 Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit “Bachelor në Gazetari” është i organizuar në lëndë bazë të detyrueshme, lëndë karakterizuese, lëndë ndërdisiplinore/integruese, plotësuese dhe detyrime përmbyllëse, duke respektuar legjislacionin vendas në fuqi dhe Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ETCS). Kjo vërtetohet në evidencat e planit mësimor, sylabuset e lëndëve, etj.</p> <p><i>Evidenca 3.14 Korniza konceptuale e programit të studimit “Bachelor në gazetari”;</i> <i>Evidenca 3.15 Plani mësimor i programit të studimit “Bachelor në gazetari”;</i> <i>Evidenca 3.16 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit (syllabuset);</i> <i>Evidenca 1.8–Rregullore e programit të studimit “Bachelor në Gazetari”;</i> <i>Evidenca 1.19 Vendimi për hapjen e departamentit të letërsisë dhe gazetarisë;</i> <i>Evidenca 1.18 Strategjia e zhvillimit të programit të studimit “Bachelor në gazetari”;</i> <i>Evidenca 1.14 Rregullore e departamentit të letërsisë dhe gazetarisë;</i> <i>Evidenca 1.25 Urdhri për hapjen e programit të studimit “Bachelor në gazetari”.</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Parashikuar edhe në rregulloren e programit të studimit “Bachelor në Gazetari” ky program ka për mision të formojë studentë duke u bazuar në njohuri që ndërthurin disiplina.</p> <p>Konkretisht, misioni i këtij programi theksohet se është:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të krijojë, të zhvillojë, të përcjellë dhe të mbrojë dijet përmes mësimdhënies, kërkimit shkencor; - Të formojë specialistë në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit, duke kontribuar në rritjen e standardeve të demokracisë në vend; - Të ofrojë një program mësimor konkurrues bazuar në cilësinë e mësimdhënies dhe kurrikula bashkëkohore, për të kontribuar në përmirësimin e cilësisë së jetës dhe zhvillimin e qëndrueshëm të Republikës së Shqipërisë; - Të japë njohuritë bazë për gazetarinë, shkencat e komunikimit dhe fusha të tjera të ndryshme të përcjelljes së informacionit me anë të mjeteve të ndryshme, për t’u mundësuar studentëve ndërtimin e një karriere profesionale, jo vetëm në sektorin publik, por edhe në atë privat. Gjithashtu të japë njohuri plotësuese për ato fusha që ndihmojnë dhe japin mundësi zhvillimi të mëtejshëm, në drejtime të tjera studimi, të cilat janë të lidhura ngushtësisht me natyrën e komunikimit. <p><i>Evidenca 3.14 Korniza konceptuale e programit të studimit;</i></p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p><i>Evidenca 3.16 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit (syllabuset);</i> <i>Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit "Bachelor në gazetari";</i></p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga institucioni, konkretisht, plani mësimor, korniza konceptuale e programit, programet e lëndëve të prezantuara përmes syllabuseve, dhe rregullores së programit, u konstatua se Programi i studimit "Bachelor në Gazetari" organizohet në:</p> <p><i>A. Lëndë bazë - përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme - 35 kredite = 19.5% të totalit të krediteve.</i> <i>B. Lëndë karakterizuese - përgatitje për disiplinën shkencore - 94 kredite= 52.2% të totalit të krediteve.</i> <i>C. Lëndë ndërdisiplinore/integruese - ndërdisiplinore, profile dhe gruplëndë me zgjedhje -23 kredite = 17.8% të totalit të krediteve.</i> <i>D. Lëndët plotësuese- praktika profesionale 22 kredite = 12.2% të totalit të krediteve.</i> <i>E. Detyrime përmbyllëse – mikroteza 6 kredite = 3.3% të totalit të krediteve sipas përcaktimeve në aneksin e tabelave përmbledhëse.</i></p> <p>Çdo lëndë/modul në program dallohet nga emërtimi, kodi dhe numri i krediteve.</p> <p>Veprimtaritë formuese që karakterizojnë programin e studimit janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - mësimi në auditor (leksione, seminare, ushtrime); - studimi individual (hulumtimi, kërkimi, studimi, punim relacionesh, detyrat apo projektet, përgatitjet e provimeve, përgatitja e tezës së diplomës, etj); - veprimtari të tjera të lidhura ngushtësisht me aspekte profesionale, si praktikë në laboratore apo në terren. <p><i>Evidenca 3.14 Korniza konceptuale e programit të studimit "Bachelor në gazetari";</i> <i>Evidenca 3.15 Plani mësimor i programit të studimit "Bachelor në gazetari"; Evidenca 3.16 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit (syllabuset) "Bachelor në gazetari"</i> <i>Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit "Bachelor në gazetari";</i> <i>Evidenca 1.9 Pasqyrimi i kodifikimit të lëndëve të programit të studimit "Bachelor në gazetari"</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të përmendur edhe në kriterin e mësipërm konstatohet se Programi i studimit "Bachelor në Gazetari" ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p> <p><i>Evidenca 3.15 Plani mësimor i programit të studimit "Bachelor në gazetari"; Evidenca 3.16 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit (syllabuset) "Bachelor në gazetari";</i> <i>Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit "Bachelor në gazetari";</i> <i>Evidenca 1.33 Paketa e praktikës për programin e studimit "Bachelor në gazetari";</i> <i>Evidenca 1.13 Lista e marrëveshjeve për zhvillimin e praktikave</i></p>



<p>Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Bordi i Administrimit të UNIEL, përmes vendimit me nr.38, datë 02.11.2021, me nr.protokolli 2360/1 parashikon procedurën e aplikimit të studentëve në Ciklin e Parë të studimeve, me program të parë studimi, që përfitojnë bursë financiare dhe përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit, si studentë të shkëlqyer, studentë me rezultate dhe me kritere të tjera. Sipas këtij vendimi. Modelet e financimit të studentëve janë dy: Financimi nëpërmjet bursave dhe financimi nëpërmjet përjashtimit nga tarifatat e studimit. Financimi bëhet për dy kategori: a) Financimi për studentët me rezultate të shkëlqyera dhe b) financimi i studentëve përfitues sipas kritereve të tjera të vendosur nga aktet nënligjore. Vendimi parashikon që në fillimin e çdo viti akademik, të realizohen procedurat përkatëse. Nga ana tjetër, burimet e financimit të UNIEL parashikohen në nenin 74 të statutit, ku konkretisht theksohet se</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. UE financohet nga: <ol style="list-style-type: none"> a) Buxheti i shtetit; b) pagesat e studentëve për arsimin; c) të ardhurat për shërbimet e kryera; d) të ardhurat e krijuara nga marrëdhëniet me palët e treta; e) donacione dhe burime të tjera të ligjshme financimi; f) veprimtari kerkimore-shkencore. 2. Të ardhurat e përfituara nga shërbimet, veprimtaritë kërkimore-shkencore, konsulencat, si dhe çdo e ardhur që realizohet nga veprimtaria ku merr pjesë personeli akademik, ndahet ndërmjet personelit akademik të UE-së, sipas rregullores së miratuar nga Bordi i Administrimit.
<p>Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p><i>Evidenca 2.1 Vendimi i Bordit të Administrimit për bursat dhe përjashtimet</i></p> <p>Referuar planit mësimor të këtij programi, dhe disa modeleve të ngjashme që ofrohen nga IAL-të shqiptare në këtë fushë studimi, me emërtesë të njëjtë ose të ngjashme, mund të themi se programi i studimit “Bachelor në Gazetari” ka një përmbajtje të ngjashme në nivelin e përcaktuar nga ky kriter.</p> <p><i>Evidenca 3.15 Plani mësimor i programit të studimit “Bachelor në gazetari”; Evidenca 3.16 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit (syllabuset) “Bachelor në gazetari”</i></p>
<p>Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p> <p><i>Evidenca 1.25 Urdhri për hapjen e programit të studimit “Bachelor në gazetari”; Evidenca 1.18 Strategjia e zhvillimit të programit të studimit “Bachelor në gazetari”; Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit “Bachelor në gazetari”; Evidenca 3.14 Korniza konceptuale e programit të studimit “Bachelor në gazetari”; Evidenca 3.15 Plani mësimor i programit të studimit “Bachelor në gazetari”; Evidenca 3.16 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit (silabuset) “Bachelor në gazetari” Evidenca 1.9 Pasqyrimi i kodifikimit të lëndëve të programit të studimit “Bachelor në gazetari”</i></p>

Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Nuk aplikohet.			
Konkluzione	<p><i>Nga sa më sipër, konstatohet se elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve; Programi i studimit ka një mision dhe objektiva të qartë që synojnë formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, duke ofruar njohuri të përparuar në fushën e studimit; janë përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kreditë; ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse; mbështetet në udhëzimet e MAS dhe kuadrit ligjor në fuqi për formën e organizimit të studimeve, pranimin të studentëve dhe financimit të institucionit; si edhe ka ngjashmëri brenda parashikimeve të kriterëve respektive me programet e ngjashme në IAL-të shqiptare.</i></p> <p><i>Nisur mbi këto gjykime, vlerësojmë se kriteret e këtij standardi përmbushen plotësisht.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi II.2
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	<p>Departamenti i Letërsisë dhe Gazetarisë, si njësi bazë që ofron programin e studimit “Bachelor në Gazetari”, është pjesë e Fakultetit të Shkencave Humane, e cila është edhe njësia kryesore përgjegjëse për këtë program. Kjo njësi kryesore ka në përbërje të saj katër departamente si dhe 1 qendër kërkimore, i organizuar kështu në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.</p> <p>Nga verifikimet e bëra rezultoi se në hartimin dhe organizimin e këtij programi studimi, janë mbajtur parasysh kriteret dhe standardet e vendosura sa nga kuadri ligjor në Republikën e Shqipërisë, po ashtu edhe Procesit të Bolonjës.</p> <p>Në total departamenti i i letërsisë dhe gazetarisë përbëhet nga një personel akademik efektiv prej 10 anëtarësh me grada dhe tituj, sipas përcaktimeve për departamentin në Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 80/2015, datë 22.07.2015.</p> <p>Përsa i përket akreditimit, UNIEL ka kaluar me sukses akreditimin institucional në vitin 2020 nga agjencia e akreditimit ASCAL. Ndërsa në nivel programi studimor, ky është procesi i parë i akreditimit që programi “Bachelor në Gazetari” po i nënshtrohet.</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

	<p><i>Evidenca 1.5 Urdhri i hapjes UNIEL;</i> <i>Evidenca 1.6 Certifikata e Akreditimit Institucional;</i> <i>Evidenca 1.10 Struktura organizative e UNIEL dhe e FSHH-së;</i> <i>Evidenca 1.24 Urdhër "Për hapjen e Fakultetit të Shkencave Humane";</i> <i>Evidenca 1.19 Vendimi për hapjen e departamentit të letërsisë dhe gazetarisë;</i> <i>Evidenca 1.25 Urdhri për hapjen e programit të studimit "Bachelor në gazetari";</i> <i>Tabela 1 - Numri i personelit akademik për çdo njësi bazë;</i> <i>Tabela 2 - Personeli akademik efektiv dhe me kontratë që mbulon programin e studimit "Bachelor në gazetari"</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave Humane, si njësi kryesore përgjegjëse për programin e studimit "Bachelor në Gazetari", ka angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave profesionale. Kjo bëhet nëpërmjet personelit përgjegjës për menaxhimin e Laboratorit të Multimedias, i cili është i dedikuar për programin dhe për departamentin në tërësi.</p> <p><i>Evidenca 1.16 Strategjia e zhvillimit të Fakultetit të Shkencave Humane;</i> <i>Evidenca 1.7 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane;</i> <i>Evidenca 4.6 Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e Fakultetit të Shkencave Humane;</i> <i>Evidenca 4.7 Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e laboratorëve të Fakultetit të Shkencave Humane</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Nga verifikimi i dokumentacionit dhe kompetencat e parashikuara në rregulloren e programit të studimit u konstatua se ecuria dhe zhvillimi i programit "Bachelor në Gazetari" koordinohet nga përgjegjësi i Departamentit të Letërsisë dhe Gazetarisë në bashkëpunim me koordinatorin e programit të studimit. Ky i fundit zgjidhet me vendim departamenti. Roli i tij parashikohet në rregulloren e programit, në nenin 4.2., ku konkretisht thuhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Koordinator i programit të studimit mbështet planifikimin, bashkërendon dhe mbikëqyr veprimtarinë e programit të studimit që mbulon, për të siguruar përmbushjen e misionit dhe objektive të programit. <p>Funksionet e tij janë të plota për të mundësuar ecurinë e programit të studimit, dhe përcaktohen qartë dhe në mënyrë të detajuar në nenin 4.2.2 të kësaj rregulloreje.</p> <p><i>Evidenca 1.22 Vendim për caktimin e koordinatorit të programit të studimit "Bachelor në gazetari";</i> <i>Evidenca 1.23 Përshkrimi i detyrave të koordinatorit të programit të studimit;</i> <i>Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit "Bachelor në gazetari"</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Organizimi i Fakultetit të Shkencave Humane si njësi kryesore dhe i Departamentit të Letërsisë dhe Gazetarisë si njësi bazë është brenda kritereve dhe normave të parashikuara nga kuadri ligjor. Përsa i përket stafit akademik efektiv në këtë departament, ai i përmbush detyrimet ligjore. Institucioni garanton ecurinë dhe zhvillimin e programit të studimit përmes detyrave dhe përgjegjësive që i njej koordinatorit të programit.</i></p>

	Në këto kushte, vlerësojmë se kriteret e këtij standardi përbushen plotësisht.			
Shkalla e përbushjes së standardit	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht	
			X	

Standardi II.3 Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Evidencat e paraqitura nga institucioni janë tregues i qartë se Departamenti i Letërsisë dhe Gazetarisë pranë Fakultetit të Shkencave Humane disponon informacionin e duhur për strukturimin e programit “Bachelor në gazetari”. Për organizimin dhe mbarëvajtjen e institucionit në nivel institucional, njësie kryesore dhe njësie bazë, pa përjashtuar këtu edhe normat që garantojnë mbarëvajtjen e programeve të studimit, Departamenti i Letërsisë dhe Gazetarisë ka vënë në dispozicion një sërë evidencash, që nga plani strategjik institucional, statuti i UNIEL, rregullorja e studimeve UNIEL, rregullorja e Fakultetit të Shkencave Humane, rregullorja e programit të studimit “Bachelor në gazetari” e deri tek rregullorja e sekretarisë mësimore. Kjo listë dokumentacioni i verifikua edhe përmes faqes së internetit të UNIEL, ku të gjitha ishin të aksesueshme për të interesuarit. Struktura dhe organizimi i programit është në përputhje me kriteret dhe standardet e vendosura nga kuadri ligjor në fuqi.</p> <p><i>Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit “Bachelor në gazetari”;</i> <i>Evidenca 3.14 Korniza konceptuale e programit të studimit “Bachelor në gazetari”;</i> <i>Evidenca 3.15 Plani mësimor i programit të studimit “Bachelor në gazetari”;</i> <i>Evidenca 3.16 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit (silabuset) “Bachelor në gazetari”;</i> <i>Evidenca 1.33 Paketa e praktikës për programin e studimit “Bachelor në gazetari”</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Plani mësimor për programin “Bachelor në Gazetari” i vënë në dispozicion përfshin informacionin e nevojshëm në lidhje me ndarjen e lëndëve në semestra; ngarkesën mësimore e cila përfshin ngarkesën në orë në auditor, e përbërë nga komponentët mësimorë, leksionet, seminarët, laboratorët, praktikat, forma të kontrollit të vazhduar; si edhe orët jashtë auditorit. Ngarkesa mësimore javore në auditor, për leksione, seminare, forma të kontrollit të vazhdueshëm është deri në 25 (njëzet e pesë) orë mësimore 50- minutëshe.</p> <p>Nga verifikimi i dokumentacionit u verifikua se për vlerësimin e dijeve të përfituara përdoren forma të ndryshme kontrolli, që kombinojnë vlerësimin e vazhduar me atë përfundimtar. Departamenti i Letërsisë dhe Gazetarisë pranë UNIEL ka dokumentuar ka të dokumentuar të gjitha syllabuset e lëndëve. Në to janë paraqitur në mënyrë të detajuar elementët përkatës: emërtimi i lëndës/modulit, viti/semestri kur zhvillohet lënda, emri dhe kualifikimi i pedagogut që do të zhvillojë lëndën, vendin që zë lënda në</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

	<p>formimin tërësor të studentit, njohuritë dhe aftësitë që i jep studentit kjo lëndë, temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik, ngarkesa në orë në auditor si dhe kreditet në ECTS, format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre, format e vlerësimit të studentëve dhe detyrimet e tyre për lëndën, si dhe literaturën e detyruar dhe ndihmëse, respektimin e Kodit të Etikës, duke qenë në përputhje me kërkesat ligjore.</p> <p><i>Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit "Bachelor në gazetari"; Evidenca 3.14 Korniza konceptuale e programit të studimit "Bachelor në gazetari"; Evidenca 3.15 Plani mësimor i programit të studimit "Bachelor në gazetari; Evidenca 3.16 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit (silabuset) "Bachelor në gazetari".</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Këto të dhëna janë të shpjeguara qartë në disa prej rregulloreve të paraqitura nga institucioni, konkretisht në Statutin e UNIEL Neni 49 mbi pranimit në ciklin e parë të studimeve, dhe Neni 58 mbi transferimin e studimeve. Të njëjtat kritere parashikohen edhe në Rregulloren e programit të studimit, konkretizuara më tej përmes vendimit për miratimin e kuotave të pranimit për programin e studimit (Evidenca 1.2.) dhe vendimit për miratimin e kritereve të pranimit për programin e studimit (Evidenca 1.21.)</p> <p><i>Evidenca 1.1 Statuti i UNIEL, kreu VII, nenet 49, 57, 58; Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit "Bachelor në gazetari; Evidenca 1.20 Vendim për miratimin e kuotave të pranimit për programin e studimit; Evidenca 1.21 Vendim për miratimin e kritereve të pranimit për programin e studimit</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarat apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Institucioni ka vënë në dispozicion informacione të nevojshme që vërtetojnë se programet e lëndëve përmbajnë informacionet e nevojshme për leksionet, praktikat, seminarat apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p> <p>Syllabuset për secilën lëndë janë të plota dhe të pajisura me të gjithë elementët e nevojshëm:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Pedagogu i lëndës • Përmbledhjen dhe rezultatet e të nxënit; • Përcaktimin e lëndës si të detyrueshme ose me zgjedhje; • Konceptet themelore që do të trajohen gjatë semestrit; • Orët në auditor dhe si punë individuale; • Temat e programit mësimor të lëndës specifike; • Formën e kontrollit të dijeve; • Literaturën bazë, literaturën ndihmëse; • Kreditet e mundshme etj.; • Kërkesat/udhëzimet për respektimin e kodit të etikës.

	<p><i>Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit "Bachelor në gazetari"; Evidenca 3.14 Korniza konceptuale e programit të studimit "Bachelor në gazetari"; Evidenca 3.15 Plani mësimor i programit të studimit "Bachelor në gazetari"; Evidenca 3.16 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit (silabuset) "Bachelor në gazetari".</i></p>			
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Departamenti i Letërsisë dhe Gazetarisë ka dokumentuar analizat vjetore që zhvillohen në nivel njësie bazë dhe njësie kryesore, ku shpjegohet mënyra e vlerësimit të programit në fjalë. Këto kryhen përmes analizës vjetore të departamentit, diskutimit dhe miratimit në departament, duke synuar përmirësimin e përmbajtjes, literaturës, metodologjisë etj, dhe kurrikulën.</p> <p><i>Evidenca 1.32 Analiza vjetore e departamentit të letërsisë dhe gazetarisë 2020-2021/2021-2022;</i> <i>Evidenca 1.31 Analiza vjetore e Fakultetit të Shkencave Humane 2020-2021/2021-2022;</i> <i>Evidenca 3.13 Informacion për politikën e zhvillimit dhe të përmirësimit të kurrikulave</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Nga verifikimet e bëra në dokumentacionin e paraqitur, rezulton se Fakulteti i Shkencave Humane dhe Departamenti i Letërsisë dhe Gazetarisë pranë UNIEL disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve. Kjo mundësohet përmes rregulloreve në nivel institucional, njësie kryesore, njësie bazë dhe programi studimi. Programi "Bachelor në Gazetari" përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jasthë auditorit. Ky program përmban informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve, si edhe sylabuse të detajuar me të gjithë elementët e nevojshëm. Në funksion të përmirësimit dhe përditësimit të programit, Departamenti i Letërsisë dhe Gazetarisë zhvillon analiza vjetore në fund të çdo viti akademik.</i></p> <p>Kriteret e parashikuara në këtë standard përmbushen plotësisht.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënësve dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë,</p>	<p>Nga verifikimi i planit mësimor, sylabuseve, rregullores së programit dhe kornizës konceptuale të programit të studimit Bachelor në Gazetari, vihet re se emërtimi, përmbajtja e njohurive për secilën lëndë, shpërndarja e ngarkesës mësimore teorike dhe praktike si dhe praktikatat e ndryshme</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

<p>thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>brenda dhe jashtë kurrikulës akademike u mundëson studentëve njohuri teorike dhe praktike për kalimin sa më me lehtësi nga auditorët e universitetit në tregun e punës. Kurrikula është organizuar në një mënyrë të tillë që lëndët e njëpasnjëshme plotësojnë njëra-tjetrën, duke iu mundësuar studentëve njohuri solide sa nga aspekti profesional, po aq edhe për vijimësinë e studimeve në ciklet pasrëndëse.</p> <p><i>Evidenca 3.14 Korniza konceptuale e programit të studimit "Bachelor në gazetari";</i> <i>Evidenca 3.15 Plani mësimor i programit të studimit "Bachelor në gazetari";</i> <i>Evidenca 3.16 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit (silabuset) "Bachelor në gazetari";</i> <i>Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit "Bachelor në gazetari"</i></p>
<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.</p>	<p>Referuar evidencave të përmendura në kriterin e mësipërm, konstatojmë se lëndët / modulet në programin "Bachelor në Gazetari" janë shpërndarë në mënyrë të tillë që t'u përgjigjen kompetencave të propozuara të programit me synimin e arritjes së rezultateve të të nxënit që u korrespondojnë këtyre kompetencave. Kurrikula është e organizuar në mënyrë të tillë, ku lëndët e vitit të parë janë kryesisht lëndë bazë dhe të formimit të përgjithshëm, me synimin për të zhvilluar më tej kompetencat bazë komunikative, gjuhësore dhe letrare dhe arritjen e rezultateve që u korrespondojnë. Lëndët e vitit të dytë janë kryesisht lëndë karakterizuese, me synimin e zhvillimit të kompetencave humultuese dhe shkencore, ndërsa ato të vitit të tretë janë karakterizuese dhe integruese, thellojnë formimin shkencor dhe japin formim profesional në komunikim dhe metoda kërkimore për të formuar më tej kompetencat e fushës/profesionale dhe rezultatet e tyre të të nxënit.</p> <p><i>Evidenca 3.14 Korniza konceptuale e programit të studimit "Bachelor në gazetari";</i> <i>Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit "Bachelor në gazetari";</i> <i>Evidenca 3.15 Plani mësimor i programit të studimit "Bachelor në gazetari";</i> <i>Evidenca 3.16 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit (silabuset) "Bachelor në gazetari"</i></p>
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Po, referuar modeleve të ngjashme në institucionet e arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit që ofrojnë këto programe, struktura e programit "Bachelor në Gazetari", lëndët dhe raporti teori praktikë janë në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p> <p><i>Evidenca 3.14 Korniza konceptuale e programit të studimit "Bachelor në gazetari";</i> <i>Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit "Bachelor në gazetari";</i> <i>Evidenca 3.15 Plani mësimor i programit të studimit "Bachelor në gazetari";</i> <i>Evidenca 3.16 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit (silabuset) "Bachelor në gazetari"</i></p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues,</p>	<p>Ndarja sipas veprimtarive formuese në program është në përputhje të plotë me kërkesat ligjore, duke lehtësuar transferimin dhe lëvizshmërinë e studentëve.</p> <p>Konkretisht, ndarja është si më poshtë: - A. Lëndë bazë - 35 kredite = 19.5%.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

<p>transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>- B. Lëndë karakterizuese - 94 kredite = 52.2% të totalit të krediteve. - C. Lëndë ndërdisiplinore/integruese, me zgjedhje -23 kredite = 17.8% t. - D. Lëndët plotësuese- praktika profesionale 22 kredite = 12.2%. - E. Detyrime përmbyllëse – mikroteza 6 kredite = 3.3%.</p> <p><i>Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit "Bachelor në gazetari"; Evidenca 3.14 Korniza konceptuale e programit të studimit "Bachelor në gazetari"; Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit "Bachelor në gazetari"; Evidenca 3.15 Plani mësimor i programit të studimit "Bachelor në gazetari"; Evidenca 3.16 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit (silabuset) "Bachelor në gazetari"; Evidenca 3.1 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit Erasmus+; Evidenca 3.2 Të dhëna për mobilitetin e personeleve.</i></p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Nga takimet e zhvilluara veçmas me përgjegjës të departamentit dhe me stafin akademik të angazhuar në këtë program studimi, por edhe nga evidencat që shoqërojnë Raportin e Vlerësimit të Brendshëm, u konstatua se Departamenti i Letërsisë dhe Gazetarisë e ka në praktikën e vet të përvitshme diskutimin mbi mënyrat e ndryshme të përdorura prej lektorëve për përditësimin e sillabuseve të lëndëve çdo vit akademik. Në fillim të çdo viti akademik pedagogu i lëndës dorëzon në departament programin e lëndës bashkë me përditësimet e nevojshme duke përcaktuar qartësisht literaturën e detyruar dhe literaturën ndihmëse. Ky program i dorëzohet edhe koordinatorit të departamentit.</p> <p><i>Evidenca 1.17 Strategjia e zhvillimit të departamentit të letërsisë dhe gazetarisë; Evidenca 3.15 Plani mësimor i programit të studimit "Bachelor në gazetari"; Evidenca 3.16 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit (silabuset) "Bachelor në gazetari".</i></p>
<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Kurrikula e programit "Bachelor në Gazetari" është organizuar duke u mbështetur në modelet e institucioneve të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit, e përditësuar gjithashtu edhe me dinamikën e zhvillimeve teknologjike që karakterizojnë këtë fushë studimesh. Mënyra e hartimit të planit mësimor i ndihmon studentët që të integrojnë mirë konceptet teorike me ato praktike, çka garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p> <p><i>Evidenca 3.14 Korniza konceptuale e programit të studimit "Bachelor në gazetari"; Evidenca 1.18 Strategjia e zhvillimit të programit të studimit "Bachelor në gazetari"; Evidenca 3.15 Plani mësimor i programit të studimit "Bachelor në gazetari"; Evidenca 3.16 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit (silabuset) "Bachelor në gazetari".</i></p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e</p>	<p>Po, mënyra e organizimit të përmbajtjes së programit dhe harmonizimi i lëndëve/moduleve i ndihmon studentët dhe u mundëson atyre vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe punësimin në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al


E-mail: info@asc.al

studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Lëndët teorike krijojnë një bazë njohurish të qëndrueshme që u mundëson atyre studimet në ciklet pasrendëse, ndërsa nga ana tjetër, lëndët që lidhen me praktikën profesionale, por edhe me zhvillimet teknologjike përbëjnë një bazë të mirë përgatitjen e studentëve për integrimin në tregun e punës. <i>Evidenca 1.18 Strategjia e zhvillimit të programit të studimit "Bachelor në gazetari";</i> <i>Evidenca 3.15 Plani mësimor i programit të studimit "Bachelor në gazetari";</i> <i>Evidenca 3.16 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit (silabuset) "Bachelor në gazetari".</i>		
Konkluzione	<i>Departamenti i Letërsisë dhe Gazetarisë ka treguar kujdes në hartimin e kurrikulës, duke i organizuar njohuritë në lëndë/module që plotësojnë gamën e njohurive të nevojshme për studimet në ciklet e mëtejshme dhe për integrimin e studentëve në tregun e punës. Shtirja e lëndëve në semestra ndjek një rend logjik, nga formimi bazë dhe i përgjithshëm, e deri tek lëndët karakterizuese dhe ato që ndihmojnë në zhvillimin e kompetencave hulumtuese e shkencore, por edhe në zhvillimin e aftësive praktike në ushtrimin e profesionit.</i> <i>Për sa më sipër, kriteret e këtij standardi përmbushen plotësisht.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.5


Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Referuar RVB, evidencave të paraqitura, por edhe takimeve të zhvilluara në institucion u konstatua se Departamenti i letërsisë e gazetarisë bashkëpunon me partnerë të ndryshëm, sa në fushën e medias dhe komunikimit, po aq edhe me institucione të angazhuar në këtë sektor. Falë këtij bashkëpunimi departamenti përdor eksperiencën e partnerëve për të përditësuar njohuritë e ofruara për studentët. Një rol të rëndësishëm luajnë edhe të diplomuarit nga ky departament, të cilët, sipas studentëve të kontaktuar gjatë vizitës, ndihmojnë në integrimin sa më të lehtë në tregun e punës për të rinjtë që studiojnë gazetari në UNIEL. <i>Tabela 5 - Institucionet dhe organizatat bashkëpunuese në rang programi/esh studimi për Praktikën profesionale me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë;</i> <i>Evidenca 1.29 Raport për veprimtarinë e programit të studimit "Bachelor në gazetari", për vitin akademik 2020-2021/2021-2022;</i> <i>Evidenca 1.18 Strategjia e zhvillimit të programit të studimit "Bachelor në gazetari";</i> <i>Evidenca 1.16 Strategjia e zhvillimit të Fakultetit të Shkencave Humane, 2018-2023, f.4.</i>



<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Nga vizitat e zhvilluara në institucion u vu re praktika që përdoret për mbajtjen e kontakteve të vazhdueshme me Alumnin, të diplomuarit ndër vite, të cilët së fundmi kanë dhënë një kontribut të lavdërueshëm për studentët në auditor. Shumë prej tyre janë ftuar në orë të hapura me studentët në auditor, duke synuar prezantimin e eksperiencave të tyre në tregun e punës, gjë që ndihmon të rinjtë në auditor për punësimin pas diplomimi. Vlerësimet e studentëve të diplomuar janë bërë pjesë e diskutimeve në Analizën Vjetore, nga të cilat janë bërë edhe ndryshime në përmbajtjen e sylabuseve të lëndëve të ndryshme.</p> <p><i>Evidenca 2.3 Rregullore e Këshillit Studentor;</i> <i>Evidenca Tabela 22 - Aktivizimi i studentëve në aktivitete të njësish;</i> <i>Evidenca 1.29 Raport për veprimtarinë e programit të studimit "Bachelor në gazetari" për vitin akademik 2020-2021/2021-2022;</i> <i>Evidenca 1.30 Raporti i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimeve;</i> <i>Evidenca 1.32 Analizat vjetore e departamentit të letërsisë dhe gazetarisë 2020-2021/ 2021-2022</i></p>			
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Po, kjo u vu re edhe në evidencat që shoqërojnë RVB, por edhe në takimin e zhvilluar në institucion me grupe të ndryshme. Departamenti i letërsisë dhe gazetarisë ka një bashkëpunim të ngushtë me rrjete profesionistësh, shoqata dhe institucione publike e private, me të cilët këshillohet për dinamikat që shoqërojnë industrinë e medias dhe komunikimit, për t'i reflektuar këto në përmbajtjen e njohurive që u përcillen studentëve.</p> <p><i>Evidenca 3.13 Informacion për politikën e zhvillimit dhe të përmirësimit të kurrikulave;</i> <i>Evidenca Tabela 5 - Institucionet dhe organizatat bashkëpunuese në rang programi/esh studimi për Praktikat profesionale me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë;</i> <i>Evidenca 1.34 Politika e marketingut për programin e studimit "Bachelor në gazetari";</i> <i>Evidenca 1.29 Raport për veprimtarinë e programit të studimit "Bachelor në gazetari" për vitin akademik 2020-2021/2021-2022;</i> <i>Evidenca 1.30 Raporti i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimeve.</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Pas verifikimit të dokumentacionit dhe të dhënave shtesë të marra gjatë takimeve të zhvilluara në institucion, GVJ vlerëson se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>
---	------------------------------	-----------------------------	------------------------------	----------




III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Pas verifikimit të evidencave të paraqitura në RVB, GVJ konstatoti se veprimtaritë formuese, që karakterizojnë programin e studimit “Bachelor në Gazetari”, përbëhen nga këta komponentë mësimorë: mësim në auditor (leksione, seminare, ushtrime, laboratorë, forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale, të zhvilluara në auditor; studim individual (studim a punim relacionesh, detyrash a projektsh; përgatitje për provim; përgatitje e temës së diplomës dhe veprimtari të tjera si praktika profesionale, praktika në terren ose stazh pranë subjekteve publike apo private.</p> <p>Shpjegimi i formave të mësimdhënies gjendet sa në formatin e sylabuseve, po aq edhe në veprimtaritë formuese të programit, planin mësimor, paketat e praktikës për programin, strategjinë e zhvillimit të programit, etj.</p> <p><i>Evidenca 1.16 Strategjia e zhvillimit të Fakultetit të Shkencave Humane (Baza rregullatore për mësimdhënien dhe të nxënit; Politika e sigurimit të cilësisë së FSHH);</i> <i>Evidenca 1.7 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane (neni 20, Veprimtaritë formuese të programit të studimit);</i> <i>Evidenca 3.15 Plani mësimor i programit të studimit “Bachelor në gazetari”;</i> <i>Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit “Bachelor në Gazetari” (neni 13 Njohje me mediat – Praktika profesionale);</i> <i>Evidenca 1.33 Paketa e praktikës për programin e studimit “Bachelor në gazetari”;</i> <i>Evidenca 1.18 Strategjia e zhvillimit të programit të studimit “Bachelor në gazetari” (faqe 9-10).</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Për t’u vlerësuar është fakti Departamenti i Letërsisë dhe Gazetarisë i ka kushtuar vëmendje lidhjes së natyrës së lëndëve me ekspertizën e stafit akademik. Kjo u vu re edhe gjatë takimit me grupin e studentëve, të cilët pohuan një qasje miqësore dhe komunikim të vazhduar midis tyre dhe anëtarëve të stafit akademik.</p> <p>Për sa i përket formave të mësimdhënies, ata theksuan se lëndët zhvillohen në mjedise dhe me forma varësisht natyrës së tyre. Lëndët teknike dhe me karakter profesional, zhvillohen më së shumti në ambiente laboratorike, ndërsa të tjerat në auditorë të tjerë. Ndërkohë, FSHH ka në dispozicion të studentëve ‘Qendrën e radios dhe laboratorin e gazetarisë’, e përdor gjerësisht për lëndët me karakter profesional.</p> <p><i>Evidenca 1.16 Strategjia e zhvillimit të Fakultetit të Shkencave Humane (f. 4); Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit “Bachelor në gazetari”;</i> <i>Evidenca 4.7 Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e laboratorëve të Fakultetit të Shkencave Humane;</i></p>

	<p><i>Evidenca 1.7 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane (Neni 20); Evidenca 3.15 Plani mësimor i programit të studimit "Bachelor në gazetari"; Evidenca 3.16 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit (silabuset) "Bachelor në gazetari"; Tabela 13-- Ngarkesa totale në auditor e studentëve për format e mësimdhënies në programin e studimit, për secilin program.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ vuri re se Zyra e Burimeve Njerëzore bashkëpunon me njësitë bazë për trajnimin e stafit akademik rreth temave të ndryshme, të cilat mund të kërkohen si nga vetë pedagogët, po aq edhe mund të propozohen nga vetë zyra. Kjo praktikë ndiqet për të nxitur edukimin e vazhduar qoftë edhe mes stafit akademik, për t'i ndihmuar ata të jenë sa më të përditësuar me dinamikat që shoqërojnë kompetencat didaktike dhe format e mësimdhënies.</p> <p><i>Evidenca 3.1 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit Erasmus; Evidenca 3.2 Të dhëna për mobilitetin e personeleve; Tabela 20 Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar të Fakultetit.</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>GVJ konstatoi se Departamenti i Letërsisë dhe Gazetarisë ka angazhuar staf të kualifikuar në përputhje me nevojat e këtij programi studimi. Titullarët e lëndëve që ofrohen në këtë program e përditësojnë vit pas viti programin lëndor me literaturë bashkëkohore dhe ndërfutjen e teknologjisë dhe të mësimit alternativ përmes saj.</p> <p>Fakti që programi "Bachelor në Gazetari" ka numër jo të lartë studentësh, ka ndihmuar në një komunikim më të drejtpërdrejtë midis tyre dhe stafit akademik, gjë kjo që ndikon në motivimin e palëve gjatë procesit mësimor. Komunikimet e vazhduara përtej auditorëve, i ndihmojnë studentët për të fituar edhe kompetenca të tjera të nevojshme në profesion, por jo vetëm. Kjo ishte një nga pikat e forta të prezantuara nga vetë studentët që u takuan gjatë vizitës në mjediset e Departamentit të letërsisë dhe gazetarisë.</p> <p><i>Evidenca 1.1 Statuti i UNIEL (neni 62 Veprimtaria kërkimore-shkencore); Evidenca 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL; Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit (neni 4.2.2 pika 20 dhe 4.4); Evidenca 1.17 Strategjia e zhvillimit të departamentit të letërsisë dhe gazetarisë (faqe 9); Evidenca 4.2 Rregullore e modaliteteve të rekrutimit të personelit akademik UNIEL; Tabela 7 Të dhënat e stafit akademik për "Bachelor në gazetari", sipas kualifikimit dhe raportet e tyre; Tabela 19 Veprimtari shkencore individuale të stafit akademik në funksion edhe të programit të studimit, në vitet e fundit; Tabela 22 Aktivizimi i studentëve në aktivitete të njësisë, në tre vitet e fundit.</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë</p>	<p>Mbështetur në praktikën e paraqitura përmes RVB dhe informacioneve të mbledhura në Institucion, u vu re se Departamenti i letërsisë dhe komunikimit merr mendimin e studentëve për përmirësimin e punës dhe planeve mësimore përmes dy formave kryesore: së pari, përfaqësuesit e studentëve për çdo vit përcjellin pranë departamentit shqetësimet, kërkesat dhe nevojat që mund të kenë në lidhje me çështje të caktuara; dhe së dyti,</p>

<p>studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.</p>	<p>ka një pyetësor të përgatitur nga NJSBC, të dhënat dhe sugjerimet e të cilit përdoren për përmirësimin e metodave të mësimdhënies në mënyrë periodike.</p> <p>Në këtë pikë, <i>Grupi i Vlerësimit të Jashtëm</i> sugjeron që pyetësorët e përgatitur nga NJSBC duhet të zhvillohen jo vetëm për të siguruar të dhëna dhe vlerësime mbi kushtet që ofron UE, por duhet të zbresin deri në nivel matjeje performance të pedagogut dhe lëndëve specifike.</p> <p><i>Evidenca 5.13 Vendim i FSHH-së për ngritjen e Njesisë së Sigurimit të Cilësisë;</i> <i>Tabela 24 Të dhëna për anëtarët e NJSBC; Evidenca 6.2 Publikimi i Raportit 2021-2022;</i> <i>Evidenca 1.1 Statuti i UNIEL (neni 67 pika 5); Evidenca 6.3 Urdhrat për zhvillimin e pyetësorëve institucionalë 2021-2022;</i> <i>Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit "Bachelor në gazetari" (neni 29 Të drejtat e studentit pika 13)</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>Siç u përmend edhe në kriterin e mësipërm, <i>GVJ</i> sugjeron që NJSBC duhet të zgjerojë indikatorët e vlerësimit të cilësisë jo vetëm për matjen e cilësisë së shërbimit në nivel institucional, por edhe për matjen e performancës së pedagogëve për lëndë të veçanta, gjë kjo që do të ndihmojë Departamentin për të bërë ndërhyrjet e nevojshme aty ku kërkohet nga studentët.</p> <p>Pyetësorët e zhvilluara deri më tani, prezantojnë të dhëna cilësinë e shërbimit në nivel institucional, apo njësie kryesore dhe njësie bazë. <i>GVJ</i> sugjeron që këta indikatorë të zgjerohen edhe në rrafsh të tjera, si p.sh. vlerësimi i stafit akademik ndaj institucionit, vlerësimi i stafit administrativ ndaj institucionit, përcaktimi dhe unifikimi në nivel institucional i standardeve të vetëvlerësimit të personelit akademik dhe administrativ, etj.</p> <p><i>Evidenca 3.3 Të dhëna mbi aktivitetet 2021-2022;</i> <i>Evidenca 3.4 Të dhënat mbi revistën periodike BULETINI UNIEL;</i> <i>Evidenca 3.5 Marrëveshja për krijimin e qendrës;</i> <i>Evidenca 1.32 Analizat vjetore e departamentit të letërsisë dhe gazetarisë 2020-2021/ 2021-2022.</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ</i> konstatoi se Departamenti i letërsisë dhe gazetarisë në programin "Bachelor në gazetari" ka angazhuar një staf të kualifikuar, me ekspertizën e duhur për lëndët që ofrojnë, dhe përdorin forma të mësimdhënies në përputhje me kriteret ligjore, në mjedise të përshtatshme me njohuritë teorike dhe praktike.</p> <p>Ndërkohë, <i>GVJ</i> sugjeron që NJSBC duhet të zhvillojë disa standarde cilësie që shkojnë përtej vlerësimeve në nivel institucional, njësie bazë apo njësie kryesore, dhe të masin performancën deri në nivel individual të stafit akademik, për tu zgjeruar deri në lëndë specifike. Kjo do të ndihmojë njësitë bazë për të bërë ndryshimet dhe përmirësimet e nevojshme aty ku lind nevoja.</p> <p>Në këto kushte, <i>GVJ</i> vlerëson se ky standard përmbushet kryesisht.</p>



Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.2 Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregullore të posaçme. Sipas rregullores së programit të studimit, vlerësimi në lëndët e programit mund të bëhet: a) me provim me shkrim, me gojë ose i ndërthurur; b) me detyra kursi, projekte, postera; c) i bazuar në një shumëllojshmëri formash vlerësimi. Vlerësimi me notën përfundimtare për secilën lëndë mësimore kryhet pas përfundimit të saj. Nota më e ulët për kalim në një lëndë është nota 5 (pesë). Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistemin prej dhjetë notash.</p> <p>Ndërkohë, UNIEL zbaton prej disa vitesh dhe sistemin e automatizuar të korigjimit të provimeve.</p> <p><i>Evidenca 1.2 Rregullore e studimeve të UNIEL;</i> <i>Evidenca 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL;</i> <i>Evidenca 1.7 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane (neni 37, 38 dhe 39 Kontrolli i dijeve dhe vlerësimi);</i> <i>Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit "Bachelor në gazetari" (neni 16: Krite dhe procedura të vlerësimit);</i> <i>Evidenca 3.6 Marrëveshja për implementimin e CLEANSORE.</i></p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në sylabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Sylabuset e programit "Bachelor në gazetari" janë përgjithësisht të plotë, të përshtatura me formatin e kërkuar nga MAS, me disa përjashtime të vogla, dhe u prezantohen studentëve në çdo fillim viti akademik. Në sylabus përcaktohen qartë format e kontrollit të dites dhe frekuentimi. Secila nga mënyrat e vlerësimit ndahet me përqindje sipas zërave: Pjesëmarrja dhe aktivizimi; Kontrolli i vazhdueshëm ku përfshihen: dorëzimi i detyrave ose projekteve, provimi i ndërmjetëm dhe Vlerësimi përfundimtar. Përqindjet të cilat përkthehen në notë duhet të arrijnë në 100%.</p> <p><i>Evidenca 1.7 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane (neni 42 Mënyra e zhvillimit të provimit; neni 24 Programi i lëndës dhe neni 38 Format e kontrollit të dijeve);</i> <i>Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit "Bachelor në gazetari" (neni 16);</i> <i>Tabela 15 - Format e kontrollit të njohurive;</i> <i>Evidenca 3.16 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit (silabuset) "Bachelor në gazetari"</i></p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore</p>	<p>Mbështetur në RVB, por edhe në takimet e zhvilluara me anëtarë të stafit akademik dhe studentë të Departamentit të letërisë dhe gazetarisë, GVJ konstatoi se testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara. Përveç provimit, që është forma kryesore e kontrollit të dijeve, studenti testohet edhe me anë të formave të tjera të kontrollit të vazhdueshëm dhe kontrollit të ndërmjetëm si: seminare, detyra kursi, kolokium, detyra me shkrim dhe paraqitja e projekteve të punuara nga studenti.</p> <p><i>Evidenca 1.7 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane (neni 38 Format e kontrollit të dijeve);</i> <i>Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit "Bachelor në gazetari" (neni 16);</i> <i>Tabela 15 - Format e kontrollit të njohurive;</i> <i>Evidenca 3.16 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit (silabuset) "Bachelor në gazetari".</i></p>
<p>Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Përmes analizave vjetore që zhvillohen në fund të çdo viti akademik, të dhënave të pyetësorëve në nivel institucional, apo edhe në disa raste të zhvilluar nga vetë pedagogët e lëndëve me iniciativën e tyre, dhe sugjerimeve të ardhura nga përfaqësuesit e studentëve, Departamenti i letërsisë dhe gazetarisë angazhohet në përmirësimin e formave dhe metodave të mësimdhënies në mënyrë periodike.</p> <p>Kjo gjë u vërtetua përmes disa praktikave konkrete të prezantuara nga Departamenti gjatë vizitës në institucion, por edhe përmes evidencave që shoqërojnë RVB, si raporti i vitit 2021-2022, strategjia e zhvillimit të programit, Informacionit për politikën e zhvillimit dhe të përmirësimit të kurrikulave, analizës vjetore të departamentit të letërsisë dhe gazetarisë 2020-2021/ 2021-2022, etj.</p> <p><i>Evidenca 6.2 Publikimi i Raportit 2021-2022;</i> <i>Evidenca 1.18 Strategjia e zhvillimit të programit të studimit "Bachelor në gazetari";</i> <i>Evidenca 1.29 Raport për veprimtarinë e programit të studimit "Bachelor në gazetari" për vitin akademik 2020-2021/2021-2022;</i> <i>Evidenca 3.13 Informacion për politikën e zhvillimit dhe të përmirësimit të kurrikulave;</i> <i>Evidenca 1.32 Analiza vjetore e departamentit të letërsisë dhe gazetarisë 2020-2021/ 2021-2022.</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxëniet, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe</p>	<p>Në rregulloren e programit "Bachelor në gazetari", neni 4.4 thuhet se personeli akademik është i detyruar të bashkëpunojë dhe të bashkëveprojë në mënyrë profesionale, qytetare me kolegët, studentët dhe bashkëpunëtorët e "Bachelor në gazetari", të krijojnë një klimë bashkëpunimi me studentët dhe kolegët, të vlerësojë studentët në mënyrë profesionale dhe në kohën e parashikuar. GVJ vlerëson se ky bashkëpunim, por edhe hapësira që u krijohet studentëve për një mjedis të qetë akademik dhe profesional, ndihmon në zhvillimin e formave dhe metodave të mësimdhënies dhe inkurajon sensin e autonomisë së studentëve. Kjo gjen gjithashtu mbështetje edhe me punën kërkimore që studentët mund të bëjnë me ndihmën e burimeve akademike në disa librari elektronike, ku UNIEL është abonuar.</p>

mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	<i>Evidenca 3.7 Anëtarësimi në JSTORE dhe U-Library;</i> <i>Evidenca 3.8 Fondi i Librit;</i> <i>Evidenca 3.9 Lista e aktiviteteve të Bordit Këshillimor të Biznesit 2021-2022;</i> <i>Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit "Bachelor në gazetari" (neni 4.4 gërmat g, i dhe k);</i> <i>Evidenca 1.23 Përshkrimi i detyrave të koordinatorit të programit të studimit.</i>			
Konkluzione	<i>Përfshirja e studentëve në përmirësimin e programit u evidentua nga RVB, por edhe nga vizita në Inistitucion. Gjatë takimit me studentët, përfaqësues të Senatit studentor na konfirmuan se kanë shumë bashkëpunim me departamentin dhe koordinatorin e programit të studimit. GVJ vlerëson se dokumentacioni i paraqitur i përmbush plotësisht kriteret e këtij standardi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Po, GVJ konstatoi se testimi dhe vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve. Masa e vlerësimit shprehet në përqindje dhe përfshin: Frekuentimin dhe kontrollin e vazhdueshëm ku përfshihet (Dorëzimi i detyrave/projekteve; Vlerësimi dhe pjesëmarrja në laboratorë; provimi i ndërmjetëm/kolokiumi dhe përgjigjja në provimin përfundimtar. Për lëndët të cilat konsiderohen firma, vlerësimi i vazhduar zë 100% të vlerësimit përfundimtar, ndërsa në lëndët e tjera vlerësimi i vazhduar zë së paku 40% të vlerësimit final të studentit. <i>Evidenca 1.7 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane (neni 37 Kontrolli i dijeve dhe instrumentet e vlerësimit dhe neni 42 Mënyra e zhvillimit të provimit);</i> <i>Evidenca 3.16 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit (silabuset) "Bachelor në gazetari";</i> <i>Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit "Bachelor në gazetari" (neni 18 pika 1);</i> <i>Tabela 15 - Format e kontrollit të njohurive.</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Bazuar në evidencat e paraqitura në dosjen e paraqitur për akreditim, por edhe në vëzhgimet e bëra gjatë vizitës në institucion, GVJ konfirmon se UNIEL zbaton prej disa vitesh edhe sistemin e automatizuar të korigjimit të provimeve. Ky sistem është implemtuar falë projektit CLEANSORE të financuar nga AADF. Ai ndihmon në rritjen e transparencës dhe shpjëtesisë në marrjen e përgjigjeve të testeve dhe shmangien e formave të abuzimit. <i>Evidenca 3.6 Marrëveshja për implementimin e CLEANSORE;</i>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

	<i>Evidenca 1.3 Strategjia e UNIEL</i>
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	<p>Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me silabusin dhe bazën ligjore në fuqi, gjë që garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti. Mënyra e vlerësimit u bëhet e ditur studentëve në fillim të semestrit dhe ndahet në përqindje e cila përkthehet në notë. Kjo u konstatua sa përmes evidencave të ndryshme që shoqërojnë RVB, po ashtu edhe gjatë intervistave që u zhvilluan me studentët dhe anëtarët e personelit akademik në këtë program studimi.</p> <p><i>Evidenca 1.7 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane (neni 37 Kontrolli i dijeve dhe instrumentet e vlerësimit);</i> <i>Evidenca 3.16 Programet mësimore të lëndëve të studimit të studimit (silabuset) "Bachelor në gazetari";</i> <i>Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit "Bachelor në gazetari" (neni 16 Kriteret dhe procedura të vlerësimit);</i> <i>Tabela 15 - Format e kontrollit të njohurive.</i></p>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënësve për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	<p>Referuar RVB, por edhe intervistave me anëtarët e stafit akademik dhe studentëve të këtij programi, u konstatua se vlerësimi i studentëve realizohet në bazë të përcaktimeve të rregullores së studimeve, bëhet transparent dhe sipas rastit shoqërohet me këshilla për të përmirësuar njohuritë në të ardhmen.</p> <p>Pas korrigjimit të provimeve, anëtarët e personelit akademik zhvillojnë një seancë të posaçme me studentët, të cilëve u bëjnë të ditur vlerësimet e provimeve/detyrave, të gjitha këto në mënyrë individuale, duke ruajtur të drejtën e privatësisë së gjithsecilit. Sa herë shihet e nevojshme, personeli akademik i këshillon studentët varësisht rasteve dhe nevojave specifike.</p> <p><i>Evidenca 1.7 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane (neni 38 Forma e kontrollit të dijeve);</i> <i>Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit "Bachelor në gazetari" (neni 16);</i> <i>Tabela 15 - Format e kontrollit të njohurive;</i> <i>Evidenca 3.11 Paketa e punimit të diplomës për programin e studimit (rregullorja e diplomimit)</i></p>
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	<p>UNIEL në rang institucional dhe për të gjitha programet e studimit ka implemtuar rregulla të posaçme që përcaktojnë kushtet që duhet të zbatohen nga studentët në lëndët ku vlerësimi kryhet përmes detyrimeve përkundrejt shmangies së plagjiaturës. Rregullorja e programit në fjalë (neni 18) dhe paketa e punimit të diplomës për këtë program e shprehin qartësisht detyrimin e studentit për t'iu shmangur plagjiaturës apo kopjimit në provime dhe detyra.</p> <p><i>Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit "Bachelor në gazetari" (neni 18 pika 3 Zhvillimi i provimeve dhe 30 Detyrat e studentit) ;</i> <i>Evidenca 3.11 Paketa e punimit të diplomës për programin e studimit (rregullorja e diplomimit).</i></p>
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në	<p>UNIEL përdor sistemin EMS, në të cilin kanë akses edhe anëtarët e personelit akademik, edhe studentët. Komunikimi final i notave bëhet përmes këtij sistemi, brenda afateve të parashikuara në rregulloren e</p>

<p>meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>programit (neni 19). Nga ana tjetër, studentët kanë të drejtë të ankimojnë vlerësimin në sistemin elektronik, brenda afateve të parashikuara në rregulloren e UNIEL, si dhe të diskutojnë me pedagogun e lëndës mbi arsyet që kanë çuar në këtë vlerësim.</p> <p><i>Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit "Bachelor në gazetari" (neni 19 Komunikimi i vlerësimit dhe neni 4.4 gërma k);</i> <i>Evidenca 1.7 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane (neni 37 Kontrolli i dijes dhe instrumentet e vlerësimit dhe neni 42 mënyra e zhvillimit të provimit pika 15 ;</i> <i>Evidenca 1.2 Rregullore e studimeve të UNIEL;</i> <i>Evidenca 4.11 Rregullorja EMS</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Siç u përmend edhe në dy kriteret pararendëse, studentët kanë të drejtë të ankimojnë vlerësimin në sistemin elektronik EMS, brenda afateve të parashikuara në rregulloren e UNIEL, si dhe të diskutojnë me pedagogun e lëndës mbi arsyet që kanë çuar në këtë vlerësim. Nga verifikimet në institucion u vu re se përgjigjet e tezave të provimeve ruhen në departament për 30 ditë nga data e zhvillimit të provimit. Këto praktika janë formalizuar përmes rregulloreve të studimeve të UNIEL. Rregulloreve të FSHH (neni 42), Rregulloreve të programit në fjalë (neni 19) dhe rregulloreve të EMS.</p> <p><i>Evidenca 1.2 Rregullore e studimeve të UNIEL;</i> <i>Evidenca 1.7 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane (neni 42 Mënyra e zhvillimit të provimit);</i> <i>Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit "Bachelor në gazetari" (neni 19 Komunikimi i vlerësimeve);</i> <i>Evidenca 4.11 Rregullorja EMS.</i></p>
<p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Bazuar në rregulloren e studimeve të UNIEL, në rregulloren e FSHH (neni 42.4) dhe nenit 44 të saj mbi ankimimin e studentit, por edhe në rregulloren e këtij programi studimi (neni 19), studenti ka të drejtë të ankohet si për shkeljen e procedurave të zhvillimit të provimit ashtu edhe për vlerësimin e tij në provim të pretenduar si të pamërituar. Në këtë rast ai i drejtohet me shkrim përgjegjësit të departamentit brenda ditës së marrjes së rezultatit të provimit. Në rastin kur drejtuesi i departamentit e vlerëson të arsyeshme ankesën, ai ngre një komision 'ad hoc' të përbërë nga komisioni i provimit, por edhe nga anëtarë të tjerë të cilët rivlerësojnë edhe një herë provimin dhe bëjnë ballafaqimin me studentët.</p> <p><i>Evidenca 1.2 Rregullore e studimeve të UNIEL ;</i> <i>Evidenca 1.7 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane (neni 42 pika 4 dhe 5 Mënyra e zhvillimit të provimit dhe neni 44 (Ankimimi i studentit);</i> <i>Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit "Bachelor në gazetari" (neni 19 Komunikimi i vlerësimeve)</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Për sa më sipër, GVJ vlerëson se Departamenti i letërisë dhe gazetarisë, për programin "Bachelor në Gazetari" ka miratuar dhe zbaton rregullore të qarta në lidhje me format e testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të studentëve, duke i formalizuar ato përmes sylabuseve të lëndëve. UNIEL përdor një sistem elektronik vlerësimi, si edhe sistemin EMS për të komunikuar me studentët dhe personelin</i></p>

	<p>akademik, gjë që lehtëson njohjen me vlerësimet brenda afateve të parashikuara në rregulloret përkatëse, dhe mundësinë e studentëve për të ankimuar këto vlerësime. Procesi i vlerësimit të ankimimeve të studentëve është i formalizuar dhe funksional.</p> <p>Në këto kushte, GVJ vlerëson se kriteret e këtij standardi përbushen plotësisht.</p>		
Shkalla e përbushjes së standardit	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X


Standardi III.4 Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Organizimi i programit të studimit ndihmon në thellimin e njohurive teorike, duke zhvilluar edhe aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve përmes kryerjes së praktikës, e parashikuar kjo në vitin e tretë. Nga ana tjetër, nga intervistat në institucion me studentët, GVJ konstatoi se zhvillimi i aftësive të veçanta të studentëve përvijohet edhe përmes përfshirjes së tyre në detyra dhe projekte sipas interesit që ata shfaqin.</p> <p><i>Evidenca 1.7 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane (neni 32 Organizimi i praktikave profesionale/mësimore);</i> <i>Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit "Bachelor në gazetari" (neni 12 dhe 13);</i> <i>Evidenca 1.33 Paketa e praktikës për programin e studimit "Bachelor në gazetari"</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.</p>	<p>Referuar RVB dhe përbajtjes, planit mësimor dhe infrastrukturës në funksion të programit "Bachelor në Gazetari", GVJ vlerëson se ky program krijon kushte të përshtatshme për studentët që të fitojnë dhe zhvillojnë aftësi profesionale dhe të qëndrueshme në fushën e gazetarisë dhe shkencave të komunikimit dhe profesioneve të ngjashme, për të pasur mundësi punësimi në sektorin publik dhe privat.</p> <p><i>Evidenca 1.18 Strategjia e zhvillimit të programit të studimit "Bachelor në gazetari";</i> <i>Evidenca 3.15 Plani mësimor i programit të studimit "Bachelor në gazetari"; Evidenca 3.14 Korniza konceptuale e programit të studimit "Bachelor në gazetari";</i> <i>Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit "Bachelor në gazetari".</i></p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah</p>	<p>Në fillim të çdo semestri, pedagogu u prezanton studentëve përbajtjen e sylabusit të lëndës, ku krahas temave që do të zhvillohen, ata njihen edhe me kompetencat dhe aftësitë që do të fitojnë dhe me mënyrën e vlerësimit përgjatë gjithë zhvillimit të lëndës. Kjo është dokumentuar si praktikë në RVB, por u rikonfirmua edhe gjatë takimeve të zhvilluara me personelin akademik dhe studentët e programit "Bachelor në Gazetari", pranë FSHH, UNIEL.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

<p>çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p><i>Evidenca 1.2 Rregullore e studimeve të UNIEL;</i> <i>Evidenca 1.7 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane (neni 24 Programi i lëndës);</i> <i>Evidenca 3.16 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit (silabuset) "Bachelor në gazetari"</i></p>
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Në lidhje me këtë kriter, duhet vënë në dukje fakti se grupet e studentëve në këtë program kanë një numër relativisht të ulët studentësh, gjë që nga njëra anë mundëson gjithëpërfshirjen e tyre në diskutime dhe shfrytëzimin maksimal të mundësive të mjedisve laboratorike që posedon institucioni, dhe nga ana tjetër pjesëmarrjen e tyre në projekte jashtëkurrikulare të organizuara nga stafi akademik, por jo vetëm. GVJ konstatoi se Departamenti i Letërsisë dhe Gazetarisë u mundëson studentëve një klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve novative, si edhe nxit interesat dhe nevojat profesionale për njohuri të thelluara teorike përmes organizimit të konferencave studentore dhe përfshirjes në projekte kërkimore.</p> <p><i>Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit "Bachelor në gazetari" (neni 13 Njohja me mediat dhe praktikat profesionale);</i> <i>Evidenca 1.18 Strategjia e zhvillimit të programit të studimit "Bachelor në gazetari";</i> <i>Evidenca 3.14 Korniza konceptuale e programit të studimit "Bachelor në gazetari";</i> <i>Evidenca 1.33 Paketa e praktikës për programin e studimit "Bachelor në gazetari".</i></p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Studentët që studiojnë në programin "Bachelor në gazetari" kanë mundësi të përfitojnë nga një marrëveshjet që institucioni ka nënshkruar me disa organizata/sipërmarrje/institucione publike dhe private. Kjo u verifikua përmes listës së marrëveshjeve të nënshkruara nga institucioni, por edhe bashkëpunimit efektiv që ekziston midis tyre në interes të konsolidimit të njohurive që duhet të marrin studentët. Falë numrit jo të lartë të studentëve, këta të fundit u shprehën se gjejnë mundësi të vazhdueshme për të kontaktuar personelin akademik, ku diskutojnë rreth mundësive që i ndihmojnë ata në zhvillimin profesional.</p> <p><i>Evidenca 1.18 Strategjia e zhvillimit të programit të studimit "Bachelor në gazetari";</i> <i>Evidenca 1.29 Raport për veprimtarinë e programit të studimit "Bachelor në gazetari" për vitin akademik 2020-2021/ 2021-2022;</i> <i>Evidenca 1.30 Raporti i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimeve;</i> <i>Evidenca 1.31 Analiza vjetore e Fakultetit të Shkencave Humane 2020-2021/2021-2022;</i> <i>Evidenca 1.32 Analizat vjetore e departamentit të letërsisë dhe gazetarisë 2020-2021/ 2021-2022.</i></p>



Konkluzione	<p>Nga sa u cek më sipër, GVJ vlerëson se Departamenti i Letërsisë dhe Gazetarisë përmes programit “Bachelor në Gazetari” ka kryer një punë të kënaqshme për marrëdhëniet që ndërton me studentët. Kjo nis që nga dita e parë e zhvillimit të një lëndë, e cila nis me prezantimin e syllabuseve, njohjen e mënyrës së vlerësimit dhe me detyrimet e studentëve, dhe vazhdon përgjatë të gjithë periudhës së studimeve, ku vë në dispozicion një infrastrukturë funksionale, marrëveshje me institucione/organizata/sipërmarrje publike e private, me qëllim ofrimin e njohurive të qëndrueshme teorike dhe profesionale për studentët.</p> <p>Kështu, GVJ vlerëson se kriteret e këtij standardi përbushen plotësisht.</p>		
Shkalla e përbushjes së standardit	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X

Standardi III.5 Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.</p>	<p>Procedura e detyrimeve përmbyllëse për studentët e “Bachelor në gazetari”, është e parashikuar në rregulloren studimeve UNIEL, në rregulloren e FSHH-së, në rregulloren e programit të studimit dhe në paketën e punimit të diplomës. Studentët njihen me këto rregullore në fillim të studimeve.</p> <p><i>Evidenca 1.2 Rregullore e Studimeve UNIEL;</i> <i>Evidenca 1.7 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane neni 9 programet e ciklit të parë të studimit dhe neni 57 Fitimi i diplomave të studimit);</i> <i>Evidenca 3.10 Manuali i punimit të diplomës;</i> <i>Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit “Bachelor në gazetari” (neni 15 Provimi i përgjithshëm përfundimtar , pika 1 dhe 2);</i> <i>Evidenca 3.11 Paketa e punimit të diplomës për programin e studimit (rregullorja e diplomimit).</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Siç u përmend në kriterin pararendës, Institucioni ka formalizuar përmes rregulloreve të posaçme mënyrën e plotësisht të detyrimeve përmbyllëse të studentëve. Studentit i caktohet një udhëheqës shkencor nga një prej anëtarëve të Departamentit të letërsisë dhe gazetarisë, i cili përgatit programin e punës së studentit duke vendosur edhe afatet e përafërta të përfundimit të tij. Udhëheqësi përcakton edhe grafikun e konsultimeve të programuara përgjatë të cilit pedagogu kontrollon punën e studentit. Ky proces rregullohet përmes disa rregulloreve, si ajo FSHH ku në nenin 59 i referohet mënyrës së përgatitjes së punimit të diplomës, si edhe rregullores së programit, e cila nën 15 të saj shpjegon qartësisht ‘Provimin e përgjithshëm përfundimtar’.</p> <p><i>Evidenca 1.7 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane (neni 59 Përgatitja e punimit të diplomës);</i></p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Pranë gimn. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al


E-mail: info@ascal.al

<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p><i>Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit "Bachelor në gazetari" (neni 15 Provimi i përgjithshëm përfundimtar).</i></p> <p>Departamenti i Letërsisë dhe Gazetarisë ngre një komision të bërberë nga 3 deri në 5 anëtarë sipas fushave që mbulon programi i studimit. Nga verifikimet që GVJ bëri pranë institucionit, rezultoi se teza e provimit përmban pyetje nga të gjitha fushat që përfshihen në programin e provimit. Varësisht rregullores së FSHH, neneve 9, 57 dhe 60 të saj, respektivisht mbi 'programet e ciklit të parë të studimit', fitimit të diplomave të studimit', dhe 'organizimit të provimit përfundimtar të formimit', provimi final mund të bëhet nëpërmjet mbrojtjes së temës së diplomës, e cila tregon aftësinë individuale të studentit në ndërmarrjen e studimeve për tema e çështje specifike, i udhëhequr nga një pedagog i fushës që studenti ka zgjedhur. Pasi e ka përgatitur temën, ai paraqitet para një komisioni të posaçëm të ngritur me propozim të drejtuesit të departamentit dhe të miratuar nga dekani i FSHH-së.</p> <p>Nga ana tjetër, Departamenti ka vënë në funksion të studentëve edhe një për përgatitjen e diplomës, si edhe ka një rregullore të posaçme për diplomimin.</p> <p><i>Evidenca 1.7 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane: neni 9 programet e ciklit të parë të studimit dhe neni 57 Fitimi i diplomave të studimit, neni 60 Organizimi i provimit përfundimtar të formimit);</i> <i>Evidenca 3.10 Manuali i punimit të diplomës;</i> <i>Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit "Bachelor në gazetari" (neni 15 Provimi i përgjithshëm përfundimtar , pika 1 dhe 2, neni 21 Procedura e diplomimit);</i> <i>Evidenca 3.11 Paketa e punimit të diplomës për programin e studimit (rregullorja e diplomimit)</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Referuar RVB dhe të dhënave të mbledhura gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi se në fillim të çdo viti akademik, Departamenti i letërsisë dhe gazetarië, pranë FSHH, UNIEL përcakton akset kryesore të fushave të studimit, dhe më pas i prezanton ato te studentët, duke i orientuar këta të fundit në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. E parashikuar edhe në disa rregullore brenda institucionit, në detyrat e udhëheqësit parashikohet qartë asistencë që ai duhet t'i japë studentit që drejton gjatë punimit të diplomës, e konfirmuar kjo edhe nga dy studentë alumni, të diplomuar pranë këtij departamenti, të cilët ishin të pranishëm gjatë vizitës që GVJ zhvilloi në institucion.</p> <p><i>Evidenca 1.7 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane (neni 59 përgatitja e punimit të diplomës);</i> <i>Evidenca 3.10 Manuali i punimit të diplomës;</i> <i>Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit "Bachelor në gazetari";</i> <i>Evidenca 3.11 Paketa e punimit të diplomës për programin e studimit (rregullorja e diplomimit).</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo</p>	<p>Po, GVJ vuri re një gatishmëri të anëtarëve të personelit akademik, përtej detyrimeve të parashikuara në rregullore të ndryshme, për të asistuar studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>

<p>jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p><i>Evidenca 1.7 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane (neni 59 përgatitja e punimit të diplomës); Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit "Bachelor në gazetari"; Evidenca 3.11 Paketa e punimit të diplomës për programin e studimit (rregullorja e diplomimit).</i></p>
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Vlerësimi me notë në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës parashikohet në rregulloren e programit "Bachelor në gazetari", neni 16, pikat 4-6.</p> <p>Konkretisht, provimi i përgjithshëm përfundimtar vlerësohet nga komisioni i vlerësimit i cili përbëhet nga jo më pak se tre anëtarë, të cilët caktohen nga drejtuesi i departamentit dhe i përcillet Dekanit të Fakultetit për miratim. Komisioni në përfundim të provimit ose prezentimit të temës nga secili student, bën vlerësimin e punës së tyre me notë. Notat regjistrohen në procesverbalin përkatës të firmosura nga anëtarët e komisionit dhe u komunikohen studentëve. Vlerësimi i punimit të diplomës ose të provimit përfundimtar të formimit bëhet me notë sipas standardeve e vlerësimit të përgjithshëm. Nota më e ulët kaluese është nota 5 (pesë) dhe nota më e lartë është nota 10 (dhjetë).</p> <p><i>Evidenca 1.2 Rregullore e studimeve të UNIEL; Evidenca 1.7 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane; Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit "Bachelor në gazetari" (neni 16 pikat 4-6)</i></p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Pas përfundimit të programit të studimit studenti pajiset me diplomën e titulluar "Bachelor në gazetari", listën e notave dhe me suplementin e diplomës, elementet përbërës së të cilës dhe procedura për regjistrimin përcaktohen nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.</p> <p><i>Evidenca 1.27 Shkresa e QSHA për miratimin e formatit të diplomës së programit të studimit. Modeli i diplomës të programit të studimit "Bachelor në gazetari"; Evidenca 3.12 Modeli i suplementit të diplomës të programit të studimit "Bachelor në gazetari"; Evidenca 1.1 Statuti i UNIEL (neni 61 Lëshimi i diplomave, certifikatave dhe i suplementit të diplomës pikat 1, 2, 3; neni 69 Dokumentacioni i procesit mësimor); Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit "Bachelor në gazetari" (neni 22 Marrja e Diplomës)</i></p>
<p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Ruajtja e dokumentacionit të studentit bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi. UNIEL ka një rregullore të psoaçme për ruajtjen, administrimin dhe arkivimin e dokumentacionit.</p> <p>Për raste të veçanta, kur studentit mund të kërkojë kopje të dytë të diplomës, UNIEL nuk lëshon dublikatë të diplomës, por mund të lëshojë dokument të barazvlefshëm me të në formën e një vërtetimi. Suplementi i diplomës hartohet në përputhje me kërkesat e Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë. Të dhënat e studentit ruhen në regjistra në Sekretarinë mësimore.</p>

	<p>UNIEL ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen. Dokumentacioni i studentit ruhet në bazë të akteve ligjore në fuqi dhe në bazë të rregulloreve përkatëse nga sekretaria mësimore. Informacionet për studentin ruhen edhe në sistemin EMS. Njësia kryesore krijon dosjen e studentit që në çastin e regjistrimit, dosje e cila pasurohet më tej me të dhëna në sistemin elektronik dhe në regjistrat e sekretarisë mësimore.</p> <p><i>Evidenca 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL;</i> <i>Evidenca 1.7 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane;</i> <i>Evidenca 2.4. Rregullore për ruajtjen, administrimin dhe arkivimin e dokumentacionit në UE "A.Xhuvani"</i> <i>Evidenca 1.15 Modalitetet e organizimit dhe funksionimit të sekretarisë mësimore të FSHH-së;</i> <i>Evidenca 4.11 Rregullorja EMS.</i></p>								
Konkluzione	<p><i>Përmes evidencave të paraqitura së bashku me raportin e vlerësimit të brendshëm, por edhe nga të dhënat e mbledhura nga vizita në institucion u vuri re se UNIEL ka të gjitha rregulloret e nevojshme në lidhje me mënyrën e vlerësimit të studentëve, ka personel akademik të posaçëm që asiston studentët gjatë kohës së studimeve dhe gjatë procesit të përmbylljes së diplomës, si edhe përmbush të gjitha detyrimet e parashikuara në kriteret e këtij standardi.</i></p> <p><i>Nisur nga vlerësimet e mësipërme, GVJ vlerëson se kriteret e këtij standardi përmbushen plotësisht.</i></p>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="542 1052 782 1120">Nuk përmbushet</th> <th data-bbox="782 1052 989 1120">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="989 1052 1212 1120">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1212 1052 1394 1120">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="542 1120 782 1209"></td> <td data-bbox="782 1120 989 1209"></td> <td data-bbox="989 1120 1212 1209"></td> <td data-bbox="1212 1120 1394 1209" style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA,
LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

Standardi IV.1


Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>GVJ ka verifikuar se Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” ndjek procedura ligjore transparente për rekrutimin e stafit. Këtë gjë e verifikon Statuti i këtij universiteti, si dhe përgjigjet e pedagogëve përgjatë takimit. Pedagogët u pyetën për mënyrën se si janë rekrutuar në këtë program studimi dhe GVJ vërtetoi edhe njëherë se dokumentacioni dhe procedura për këtë proces është i saktë dhe plotëson kriterin ligjor.</p> <p>Aktualisht, Departamenti i Letërsisë dhe Gazetarisë në këtë universitet ka 2 personel akademik të kategorisë “Profesor”, 6 personel të kategorisë “Lektor” me gradë shkencore “Doktor i Shkencave” dhe 2 asistentë lektorë me titullin Msc.</p> <p>GVJ u njoh me dokumentacionin e personelit akademik të këtij departamenti nga dokumentacioni i dorëzuar nga GVB. Gjatë vizitës u verifikuan dosjet e anëtarëve të departamentit që mbulojnë programin e studimit “Bachelor në Gazetari”.</p> <p><i>Evidencë: Tabela 1-Numri i personelit akademik për njësi bazë; Evidencë: Tabela 2- Personeli akademik efektiv dhe me kontratë që mbulon programin e studimit “Bachelor në Gazetari” Evidencë: Tabela 7- Të dhënat përmbledhëse të stafit akademik për “Bachelor në Gazetari” Evidencë 4.18. CV të personelit akademik të përfshirë në programin e studimit “Bachelor në Gazetari”</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Gjatë vizitës në Institucion, si dhe gjatë shqyrtimit të dokumentacionit për këtë kriter, GVJ konfirmoi ngarkesën mësimore të personelit akademik që mbulon programin e studimit “Bachelor në Gazetari”.</p> <p>Institucioni angazhon në varësi të nevojave staf akademik, i cili e mbulon ngarkesën mësimore përgjatë gjithë vitit akademik.</p> <p>Gjithashtu gjatë vizitës, GVJ u njoh edhe më gjerë me procedurën që ndiqet çdo fillim viti për shpërndarjen e ngarkesës mësimore si dhe hartimin dhe dorëzimin e programeve të lëndëve nga çdo pedagog i angazhuar në vit akademik.</p> <p>Gjatë vizitës, pas kërkesës sonë na u vu në dispozicion një nga rekrutimet më të fundit të personelit akademik (përfshirë të gjithë procedurën nga fillimi deri në fund).</p> <p><i>Evidencë: Tabela 2- Personeli akademik efektiv dhe me kontratë që mbulon programin e studimit “Bachelor në Gazetari” Evidencë: Tabelat 12-Plani mësimor I lidhur me personelin akademik përkatës</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë</p>	<p>GVJ verifikoi me kujdes kontratat individuale të punës për personelin akademik të këtij program studimi. U konstatua qartë se UNIEL garanton</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al



<p>qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>që çdo punonjës të ketë kontratën e tij si dhe sigurimin e vazhdueshëm dhe korrekt të sigurimeve shoqërore.</p> <p>Në takimin që GVJ realizoi me personelin akademik u verifikua edhe njëherë se institucioni e plotëson këtë kriter.</p> <p>Të dhënat për të kryer këtë verifikim na u vunë në dispozicion nga evidencat shoqërore të RVB, por edhe gjatë vizitës në institucion nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore.</p> <p><i>Evidenca 4.1 Listëpagesa e personelit Janar-Qershor 2022.</i></p> <p><i>Evidenca 4.2 Rregullore e modaliteteve të rekrutimit të personelit akademik UE</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>GVB na konfirmoi se rekrutimi i personelit akademik bëhet sipas procedurave të miratuara në Statusin e UNIEL. Kjo procedurë, sipas kërkesës për vendet vakante bëhet mjaft transparente me shpalljen publike. Nga përgjegjësi i departamentit na u sqarua edhe njëherë mënyra se si zhvillohet kjo procedurë, duke filluar nga vendet vakante, kriteret që duhet të plotësojë i punësuari, kualifikimi i duhur dhe përputhja me strukturën apo modulet dhe programet e lëndëve për të cilat ka nevojë departamenti. Gjithashtu, na u sqarua edhe mënyra se si procedohet deri në miratimin final nga Rektori i Universitetit.</p> <p><i>Evidenca 4.2 Rregullore e modaliteteve të rekrutimit të personelit akademik UE</i></p> <p><i>Evidenca 4.19 Kriteret për rekrutimin e personelit akademik me kohë të pjesshme.</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Sipas GVB, Institucioni garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik, pasi programi i studimit e ka dhe të domosdoshme një staf të tillë, nisur edhe nga natyra e vetë programit.</p> <p>Gjatë takimeve na u konfirmua se departamenti e angazhon stafin ndihmës akademik më së shumti në aspektin praktik.</p> <p>Po gjatë takimit me sekretarinë u njohëm me orarin mësimor, ku vumë re se lëndë të caktuara me natyrë praktike, zhvilloheshin në laboratorë për nevojat e veçanta të lëndëve. Gjithashtu, nga pedagogë dhe studentë na u konfirmua se në varësi të kërkesave specifike, pedagoët ndihmohen nga stafi ndihmës akademik.</p> <p>Në politikën e sigurimit për staf ndihmës akademik, vend parësor kishte personeli administrativ që ndihmon më së shumti në orët laboratorike të informatikës.</p> <p>Konfirmuam që në programin e studimit “Bachelor në Gazetari” ishte ndërtuar laborator i medias “Mediateka”. Stafi ndihmës akademik ishte i angazhuar për mirëmbajtjen e këtij laborator.</p> <p><i>Evidenca: 4.3 Rregullore e modaliteteve të rekrutimit të personelit ndihmës akademik</i></p> <p><i>Evidenca 4.6 Të dhëna mbi kapacitetin dhe infrastrukturën e laboratorëve të Fakultetit të Shkencave Humane</i></p> <p><i>Evidenca 4.8 Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e laboratorëve TIK</i></p>

<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Sipas GVB, por edhe nga takimi me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore konfirmuam se UNIEL, mbështetur në bazën ligjore për ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale të personelit të angazhuar e plotëson këtë kriter.</p> <p>Sikurse na u rikonfirmua edhe në takim, Drejtoria e Burimeve Njerëzore në bashkëpunim me arkiv-protokoll, mbledh dhe përditëson të gjitha të dhënat e personelit të angazhuar dhe specifikisht edhe për personelin e Departamentit të Letërsisë dhe Gazetarisë.</p> <p>Në takimin me Drejtorinë e Standardeve dhe Kurrikulave na u konfirmua sipas edhe RVB se është kjo njësi e cila ruan dhe përditëson ngarkesën mësimore për çdo semestër të vitit akademik.</p> <p><i>Evidencë: Tabela 2- Personeli akademik efektiv dhe me kontratë që mbulon programin e studimit "Bachelor në Gazetari"</i></p> <p><i>Evidencë: Tabela 4- Ngarkesa totale e personelit akademik të programit "Bachelor në Gazetari në një vit akademik."</i></p> <p><i>Evidencë: Tabelat 12-Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Sipas RVB dhe evidencave konstatohet se UNIEL ka prioritet për marrëveshjet me institucionet e tjera kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <p>Gjatë takimit me Drejtorinë e koordinimit dhe marrëdhënies me jashtë u njohëm me partneritetet që UNIEL ka me institucione të ndryshme të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit, si dhe impaktin që kanë dhënë këto marrëveshje në zhvillimin e institucionit.</p> <p>Gjithashtu, u njohëm me shumë veprimtari të përbashkëta të rëndësishme për sigurimin e cilësisë, por edhe për zhvillimin e Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani".</p> <p>Për sa i përket departamentit, nga ku buron ky program studimi, bazuar në listën e marrëveshjeve që ka UNIEL u njohëm më nga afër me realizimin e konferencës shkencore "Kujtesa kolektive në letërsi dhe media", zhvilluar në maj të 2022.</p> <p>Për t'u vlerësuar ishte edhe nënshkrimi i marrëveshjeve për realizimin e praktikave profesionale.</p> <p><i>Evidenca 3.9 Lista e aktiviteteve të Bordit Këshillimor të Biznesit 2021-2022 Tabela 5- Institucionet dhe organizatat bashkëpunuese në rang programi/esh studimi për praktikat profesionale</i></p> <p><i>Evidenca 1.30 Raporti I fundit periodik analitik I përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimeve.</i></p> <p><i>Evidenca 1.32 Analiza vjetore e departamentit të Letërsisë dhe Gazetarisë</i></p>
<p>Kriteri 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të</p>	<p>Nga GVB na u konfirmua se personi mbikëqyrës i praktikave është një ndihmë e dukshme për realizimin e praktikës. Edhe gjatë takimit me studentët na u konfirmua se ndihma konsiston në përmbushjen e detyrimeve për realizimin dhe vlerësimin e praktikës profesionale nga studentët.</p> <p><i>Evidenca 1.33 Paketa e praktikës për programin e studimit "Bachelor në gazetari"</i></p>

praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	<i>Tabela 5- Institucionet dhe organizatat bashkëpunuese në rang programi/esh studimi për praktikat profesionale</i>			
Konkluzione	<i>Nga dokumentacioni i paraqitur, por edhe nga takimet e kryera në Institucion, është e qartë se Institucioni merr masa që të realizohen rekrutimet e duhura sipas nevojave. Kërkesat dhe nevojat që ka departamenti për rekrutime, bëhen publike. Gjithashtu, është e dukshme që UNIEL merr masa për numrin e duhur të gradave dhe titujve që i duhet një departamenti. GVJ konstaton se ky standart përbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përbushjes së standardit		Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Bazuar në RVB dhe takimet me GVB, insitucioni e zhvillon veprimtarinë mësimore në mjedis me infrastrukturë të kompletuar dhe komode, të cilat janë të përshtatshme për këtë program studimi, duke qenë gjithnjë në përputhje me natyrën specifike të tij. Gjatë vizitës në institucion u konstatua se njësia bazë ka në dispozicion sallat e veta për realizimin e procesit mësimor. <i>Evidenca 4.6 Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e Fakultetit Evidenca 4.7 Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e laboratorëve TIK të Fakultetit Evidenca 4.20 Raporti i ekspertit për infrastrukturën (mbrotja nga zjarri, higjiena, sigurimi i godinës)</i>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Gjatë vizitës në insitucion si dhe bazuar në dokumentat e GVB, GVJ konstatoi se ambientet mësimore ishin të pajisura me sisteme <i>wireless</i> , video-projektorë të cilat krijojnë kushtet për realizimin me standarde të larta dhe cilësi të aktivitetit mësimor. Konfirmim për mjediset komode për realizimin e mësimin u morën edhe nga pedagogët dhe studentët gjatë takimeve në institucion. <i>Evidenca 4.6 Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e Fakultetit Evidenca 4.7 Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e laboratorëve TIK të Fakultetit Evidenca 4.20 Raporti i ekspertit për infrastrukturën (mbrotja nga zjarri, higjiena, sigurimi I godinës)</i>
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë	GVJ konstaton se në funksion të programit të studimit “Bachelor në Gazetari” janë vënë në dispozicion laboratorë informatike. Aparaturat dhe mjetet e këtyre laboratorëve janë në dispozicion të studentëve, ku këta

aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	të fundit i shfrytëzojnë për realizimin e orës mësimore, detyrave të kursit dhe punimit të diplomës. <i>Evidenca 4.6 Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e Fakultetit</i> <i>Evidenca 4.7 Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e laboratorëve TIK të Fakultetit</i> <i>Evidenca 4.20 Raporti i ekspertit për infrastrukturën (mbrotja nga zjarri, higjiëna, sigurimi I godinës)</i>		
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Gjatë vizitës në insitucion si dhe në bisedat me studentët u konstatua se në Fakultetin e Shkencave Humane ekziston një laborator funksional i teknologjisë, por që kryesisht përdoret nga studentët e gjuhëve të huaja. Laboratori i Mediatikës ka nevojë për pajisje që i përshtaten më shumë programit të studimit. Kjo gjë është theksuar gjithashtu edhe në RVB si pikë e dobët për këtë program studimi, por u theksua edhe nga studentët.		
Konkluzione	<i>Standarti përmbushet kryesisht, pasi programi i studimit ka nevojë që laboratori i Mediatikës të ketë më tepër pajisje (aparate fotografik, diktofonë, skaner), të cilat do ta afrojnë studentin më pranë profesionit. Përgatitja profesionale do të ishte më e mirë në rast se ky laborator do të funksionojë me të gjitha aparaturat e nevojshme. Këtë shqetësim na e sollën edhe studentët gjatë vizitës në institucion. Të njëjtin vlerësim përpërbushje kryesisht e vëmë re edhe në RVB që na është vënë në dispozicion.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi IV.3

IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Në takimet me pedagogët dhe studentët e këtij programi studimi konfirmuam se pedagogët përdorin literaturë bazë dhe ndihmëse për çdo lëndë. Studentët konfirmuan se literaturë bazë në disa lëndë mund të ishin edhe leksione të përgatitura nga pedagogu i lëndës. Gjithashtu, sikurse konfirmohet edhe nga RVB, por edhe gjatë takimeve, UNIEL u ka vënë në dispozicion studentëve dhe pedagogëve libraritë elektronike që gjenden në bibliotekën e universitetit. Gjatë vizitës në bibliotekë, vetëm për shkencat humane kishte 14835 tituj dhe 66480 kopje. Ky numër është konfirmuar edhe në RVB. <i>Evidenca 3.8 Fondi i Librit</i> <i>Evidenca 3.7 Anëtarësimi në JSTORE dhe U-Library</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimin e literaturës me botime të viteve të fundit.	Në RVB është deklaruar mënyra e njoftimit dhe raportimit për përditësimin e literaturës me literaturën e viteve më të fundit. Kjo gjë na u konfirmua edhe gjatë vizitës në bibliotekë, gjatë takimit me pedagogët

	<p>dhe studentët. Pedagogë dhe studentë na informuan se njoftimet bëheshin në formë verbal por edhe nëpërmjet njoftimeve online.</p> <p><i>Evidenca 3.18 Buxhetimi për pasurim të bibliotekës në vitin e fundit në nivel fakulteti Evidenca 3.21 Blerjet e fundit të bibliotekës</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në bibliotekë u vu re se kishte mjedise të mjaftueshme për të pritur studentët e këtij programi studimi dhe të tjerë.</p> <p>Gjithashtu GVJ konstatoi se në këto ambiente ofrohet akses i kufi i internetit, duke u dhënë kështu mundësi studentëve që të kërkojnë edhe në bibliotekën online. Në takimin me punonjësit e bibliotekës, por edhe sikurse është raportuar nga GVB biblioteka mësimore qëndronte e hapur edhe ditën e shtunë për pedagogët dhe studentët.</p> <p><i>Evidenca 3.8 Fondi I Librit</i> <i>Evidenca 3.7 Anëtarësimi në JSTORE dhe U-Library</i> <i>Evidenca 3.18 Buxhetimi për pasurim të bibliotekës në vitin e fundit në nivel fakulteti Evidenca 3.21 Blerjet e fundit të bibliotekës</i></p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Në RVB është deklaruar se biblioteka ka një fond fizik të pasur ku përfshihen literature të detyrueshme dhe mbështetëse në gjuhë shqipe dhe gjuhë të huaj.</p> <p>Gjithashtu në RVB insitucioni deklaroi se vetëm për shkencat humane ka 14835 tituj dhe 66480 kopje.</p> <p><i>Evidenca 3.8 Fondi I Librit</i> <i>Evidenca 3.7 Anëtarësimi në JSTORE dhe U-Library</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Sikurse deklarohet në RVB por edhe pas konstatimit të GVJ konfirmohet se në ambientet e Bibliotekës kishte akses interneti të palimituar, gjë që i ndihmon studentët për të aksesuar në bibliotekën online, për të gjetur materialet e nevojshme sipas kërkesave specifike. Vetë studentët deklaruan gjatë takimit se kishin mundësi shfrytëzimi të internetit pa pagesë</p> <p><i>Evidenca 3.7 Anëtarësimi në JSTORE dhe U-Library</i> <i>Evidenca 3.8 Fondi i Librit</i></p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Gjatë vizitës së Bibliotekës u njohëm edhe me sallën e kompjuterave që shfrytëzohet nga studentët për gjetjen e materialeve online. Në takimin me studentët, GVJ konstatoi se ata nuk kanë asnjë kufizim për përdorimin e kompjuterave në bibliotekë. Sikurse është raportuar edhe në RVB biblioteka është duke iu nënshtruar një procesi digjitalizimi, nëpërmjet një projekti të financuar nga AKKSHI dhe UNIEL. Këtë konfirmim e morëm edhe nga punonjësit e bibliotekës.</p> <p><i>Evidenca 3.7 Anëtarësimi në JSTORE dhe U-Library</i></p>

	<p><i>Evidenca 4.9 Dokumenti për njoftimin e projektit për digjitalizimin e Bibliotekës së UE.</i></p> <p><i>Evidenca 4.10. Të dhëna mbi orarin e shërbimit të bibliotekës.</i></p>			
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Sikurse është evidentuar edhe nga evidencat e RVB, Biblioteka është e organizuar në mënyrë të atillë që studentët të kenë gjithnjë akses sipas orarit të përshtatur me procesin mësimor. Biblioteka kryesore qëndron e hapur çdo ditë të javës nga ora 8:00-19:00, si dhe ditën e shtunë nga ora 8:00-16:00, tri bibliotekat e tjera sipas fakulteteve qëndrojnë të hapura nga e hëna në të premte, nga ora 8:00-16:00</p> <p>Sikurse deklarohet edhe nga vetë studentët gjatë takimit, aksesit në bibliotekë është në dispozicion të tyre.</p> <p><i>Evidenca 4.10. Të dhëna mbi orarin e shërbimit të bibliotekës.</i></p>			
<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>Sikurse vihet re edhe në Analizën vjetore insitucionale 2020-2021, UNIEL është gjithnjë në përpjekje për të garantuar pasurimin e fondit fizik dhe fondit online të bibliotekës. Bazuar në këtë analizë vjetore, UNIEL arrin të nxjerrë në pah titujt që janë gjendje për program studimi, shfrytëzimin e titujve nga studentët si dhe efektin që ka dhënë pasurimi i fondit fizik.</p> <p><i>Evidenca 1.11 Analiza vjetore insitucionale 2020-2022</i></p> <p><i>Evidenca 3.20 të dhëna për bibliotekën</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Biblioteka mbetet një pikë e fortë e UNIEL. Fondi fizik është sipas standarteve të larta. Nga takimet në UNIEL, konstatojmë nga pedagogë dhe studentë që Biblioteka online në përdorim është tepër efektive për të gjithë, në lidhje me kërkimin shkencor apo punimet akademike.</i></p> <p><i>GVJ është e mendimit se shkalla e përmbushjes së këtij standarti është plotësisht.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrohet të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>GVJ u vu në dijeni nga dokumentacioni i dorëzuar se UNIEL ka në përdorim dhe shfrytëzon për aktivitetin mësimor një sistem të automatizuar të menaxhimit të informacionit në lidhje me gjeneralitetet dhe ecurinë e studentëve. Në sistemin EMS menaxhohet dhe administrohet informacioni i studentit përgjatë gjithë jetës së tij studentore në UNIEL. Ky system është funksional dhe për të është miratuar Rregullore e veçantë për organizimin dhe funksionimin e tij. Sipas vendimit Nr 25, datë 19,04, 2020.</p> <p>Sikurse u informuam gjatë vizitës në institucion në këtë sistem kanë askes të gjithë pedagogët dhe studentët efektivë me kontratë.</p> <p>Në takimin me studentët u informuam se ata që në momentin e regjistrimit pajisem me email zyrtar që shërben për komunikimin e brendshëm. (@uniel.edu.al)</p> <p><i>Evidenca 4.11 Rregullorja e EMS</i></p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrohet informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Sipas RVB dhe takimeve me pedagogë dhe studentë, kjo platformë elektronike është tepër e rëndësishme për administrimin e brendshëm të dokumentacionit. Aksesit për informacione të stafit akademik, ndihmës akademi dhe studentët zhvillohet duke respektuar kuadrin ligjor të të dhënave personale për pedagogë dhe student.</p> <p>Studentët shprehen të kënaqur për sistemin, i cili u jep në kohë rekord mundësinë për të menaxhuar ecurinë akademike.</p> <p><i>Evidenca 4.11 Rregullorja e EMS</i> <i>Evidenca 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit të UNIEL</i></p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Sikurse referohet edhe në RVB EMS-I stafi akademik mund të realizojë shumë funksione; studentët mund të regjistrojnë lëndët dhe të kërkojnë për të dhëna që lidhen me procesim mësimor, tarifën, etj.</p> <p>Gjatë takimit me pedagogët na u theksua ndihma që i kishte dhënë Microsoft Teams përgjatë periudhës së COVID 19. Përdorimi i këtij sistemi, sipas pedagogëve është parë si një ecuri e mirë edhe përtej COVID 19 për të shpërndarë me grupet e studentëve materialet e nevojshme për lëndën.</p> <p><i>Evidenca 4.11 Rregullorja e EMS</i> <i>Evidenca 6.1 Guida e pedagogut; Mësimi online me Microsoft Teams</i></p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për</p>	<p>Në RVB raportohet se Sistemi i menaxhimit është tepër lehtësues për pedagogët, stafin mbështetës dhe studentët. Në një kohë reale cdokush mund të ketë rekorde që i takojnë, sipas aksesit që kanë.</p> <p>Vetë autoritet drejtuese dhe sekretaria mund të monitorojnë të dhënat sipas rastit. Sikurse u konfirmua dhe gjatë vizitës në institucion EMS mundëson gjenerimin e raporteve (kalueshmëri, frekuentim) sipas nevojave.</p>

organet dhe autoritetet drejtuese.	<i>Evidenca 4.11 Rregullorja e EMS</i>		
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Informacionet që lidhen me programin e studimit "Bachelor në Gazetari" janë të qarta dhe gjenden në faqen zyrtare të UNIEL. GVJ konstatoi se të gjitha informacionet në lidhje me programin gjenden në UEB vetëm gjuhën shqipe edhe pse faqja duhet të jetë edhe në gjuhë të dytë (angleze) sipas edhe rekomandimeve të akreditimit institucional të mëparshëm. <i>Evidenca 4.12 Të dhëna mbi publikimin në faqen e WEB</i>		
Konkluzione	<i>GVJ konfirmon se UE disponon një sistem të brendshëm menaxhimi insitucional, të cilin e vë në dispozicion të administrimit dhe informimit të monitorimit të aktivitetit akademik. Në lidhje me publikimin e informacioneve ato publikohen në faqen zyrtare në UEB. Rekomandojmë që faqja e UEB të jetë edhe në gjuhën angleze, sikurse e kërkon edhe standarti i cilësisë.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit është e përcaktuar që UNIEL harton një raport financiar për mbështetjen financiare të nevojshme. Sikurse edhe na u relatua gjatë vizitës në insitucion ku raport hartohet nga Drejtoria Ekonomike, e cila ua vë në dispozicion departamenteve përgjegjëse për programin e studimit. <i>Evidenca 10 Struktura organizative e UNIEL dhe FSHH-së</i> <i>Evidenca 4.16 Të dhëna që lidhen me koston e programit të studimit, plani për mbështetjen financiare për një cikël të plotë studimi</i>
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo	Në RVB është shpeguar se plani i financimit të departamentit të letërsisë dhe gazetarisë për programin e studimit "Bachelor në Gazetari" përmbledh në vetvete të gjithë komponentët për financimin e burimeve njerëzore, mirëmbajtjen e mjediseve, bibliotekës dhe pasurimin e saj. Gjatë takimit na u tha se ky raport hartohet nga Drejtoria ekonomike dhe kjo e fundit ia vë në dispozicion njësisë bazë. <i>Evidenca 10 Struktura organizative e UNIEL dhe FSHH-së</i> <i>Evidenca 4.16 Të dhëna që lidhen me koston e programit të studimit, plani për mbështetjen financiare për një cikël të plotë studimi</i>

të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.									
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Në RVB është relatuar se UE zhvillon auditime që i vijnë në ndihmë dokumentimit për gjendjen e financimit. Edhe gjatë takimeve na u bë me dije se UE analizon në mënyrë periodike treguesit e monitorimit të zbatimit të politikës financiare. <i>Evidenca 4.13 Raporti i Auditit KLSH 2022</i>								
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Bazuar në atë që shkruhet në RVB, njësitë bazë dhe njësitë kryesore nuk kanë administrator, kur në fakt në Statutin e UE, ky pozicion është i renditur si anëtar i Dekanantit, sipas Nenit 6, Kreu II dhe 18, Kreu III i Statutit. Raportimi financiar bëhet vetëm në nivel institucional								
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.	Sipas dokumentacionit dhe raportit të GVB, UNIEL garanton qëndrueshmëri financiare për zhvillimin e programeve të studimit. Rezultatet e Auditimit bëhen publike sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore. Gjatë vizitës në institucion na u konfirmua se UNIEL harton çdo vit relacion të detajuar për planin e buxhetit të institucionit. <i>Evidenca 1.4 Miratimi i Buxhetit 2021 dhe Buxhetit 2022</i> <i>Evidenca 4.15 Miratimi i regjistrimit të prokurimeve dhe shërbimeve</i>								
Konkluzione	<i>Bazuar në aktet rregullatore dhe legjislacionit në fuqi është detyrim që cdo fakultet të ketë administratoren e tij. Ligji, Nr80/2015 për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, Kreu 5, Neni 36, pika 4, Autoritetet drejtuese në IAL si dhe neni 43, pika 1, Dekanati. Kjo gjë është e theksuar edhe në vetë Statutin e UE, neni 6, Kreu II -Organet dhe autoritetet drejtuese në UE si dhe Neni 18, Kreu 3- Anëtarët e Dekanetit, ku pjesë e tij është deklaruar në këtë statut edhe Administratori i njësisë kryesore.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Asnjë përmbushje</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Asnjë përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Asnjë përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Shkalla e përmbushjes së standardevë të fushës IV	Asnjë përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	


Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1 Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Nisur nga shqyrtimi i RVB (<i>evidencat 1.2, 1.7 dhe 1.8</i>) u konstatua se institucioni ka hartuar politika të qarta që mbulojnë të gjitha aspektet që duhen për këtë cikël studimi. Këto procedura fillojnë që nga kriteret e hyrjes së studentit, kalimi nga njëri vit në tjetrin, transferimet në hyrje dhe në dalje si dhe diplomimin në përfundim të studimeve.</p> <p>Konstatohet se kriteret e përgjithshme dhe specifike janë hartuar në përputhje me këkesat e Ligjit Nr. 80/2015, dhe udhëzimet e MASR</p> <p><i>Evidenca 1.2 Rregullore e studimeve të UNIEL</i> <i>Evidenca 1.7 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane</i> <i>Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit "Bachelor në gazetari"</i></p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Gjatë takimit me përgjegjësin e njësisë bazë u bëmë me dije se departamenti ndjek politika sipas Rregullores së UNIEL dhe Fakultetit FSHH për shoqërimin e studentëve deri në diplomim. Këto politika u bëhen me dije studentëve që në hyrje të programit të studimit.</p> <p>Gjatë vizitës në IAL ne e konstatuam këtë procedurë.</p> <p><i>Evidenca 1.2 Rregullore e studimeve të UNIEL</i> <i>Evidenca 1.7 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane</i> <i>Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit "Bachelor në gazetari"</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>Pasi u konsultuam me të gjithë dokumentacionin, GVJ konfirmon se kriteret e pranimit, të përzgjedhjes së studentëve dhe të ecurisë së tyre gjatë studimit në "Bachelor në gazetari" janë transparente dhe bazohen në Statutin dhe Rregulloren e UE.</p> <p>Kriteret e pranimit janë të bëra publike.</p> <p><i>Evidenca 1.7 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane</i> <i>Evidenca 1.14 Rregullore e Departamentit të Letërsisë dhe Gazetarisë</i> <i>Evidenca 1.21 Vendim për miratimin e kritereve të pranimit në programin e studimit.</i></p>
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë</p>	<p>Në RVB të përgatitur nga Institucioni për këtë kriter, referohet se Institucioni harton dhe bën publike para çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve dhe referon për këtë procedurën e parashikuar në Rregulloren e Fakultetit. Informacioni është i aksesueshëm nga të gjithë në faqen zyrtare të UNIEL. Në këtë faqe ka informacion të bollshëm për programet e studimit që ofrohen. Të interesuarit e marrin informacionin edhe nëpërmjet sekretarisë mësimore.</p> <p><i>Evidenca 1.21 Vendim për miratimin e kritereve të pranimit për programin e studimit</i></p>



lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	<i>Evidenca 4.12 Të dhëna mbi publikim në faqen e UEB</i>			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	GVJ konfirmon se UNIEL publikon një sërë udhëzimesh në faqen e internetit të institucionit që lidhen me rregullore dhe procedura të pranimit në programet e studimit. Ndër të tjera, nga takimi me përfaqësues të Zyrës e Këshillimit të Studentit dhe Karrierës, morëm gjithashtu një konfirmim se për informimin e të interesuarëve bëhej një punë e konsiderueshme. Përmes faqes së internetit, broshurave, takimeve direkte etj, UNIEL bën publike ofertën akademike për programet që ofron. <i>Evidenca 5.1 Vendimi i senatit akademik për kapacitetet 2022-2023</i> <i>Evidenca 1.7 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane</i> <i>Evidenca 1.15 Modalitetet e organizimit dhe funksionimit të sekretarisë mësimore të FSHH</i> <i>Evidenca 4.12 Të dhëna mbi publikim në faqen e UEB</i> <i>Evidenca 5.2 Kalendar i ditëve të hapura 2022</i> <i>Evidenca 5.3 Publikimi I spotit promovues</i> <i>Evidenca 5.4 Fletëpalosje pormovuese institucionale</i>			
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	GVJ konfirmon se UNIEL harton dhe publikon kriteret në faqen e internetit të institucionit që lidhen me rregullore dhe procedura të pranimit në programet e studimit. Ndër to ka të programuara edhe politikat mbështetëse për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi ndryshe, pakicave dhe shtresave të marginalizuara. <i>Evidenca 5.1 Vendimi i senatit akademik për kapacitetet 2022-2023</i>			
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	GVJ konfirmon se UNIEL harton dhe publikon kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtetet e tjera, mbi bazën e propozimeve të departamenteve. Deri tani departamenti nga ku buron ky program studimi ka të parashikuar në kuotat e tij vetëm për kandidatë shqipfolës. <i>Evidenca 5.1 Vendimi i senatit akademik për kapacitetet 2022-2023</i>			
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	GVJ konfirmon se UNIEL harton politika të ndihmës/bursave për shresat në nevojë, duke u bazuar në vendimin e Bordit të Administrimit. Gjithashtu konfirmohet se UNIEL zbaton politika mbështetëse për individët me aftësi të veçanta, pakicave dhe shtresave të marginalizuara sipas kuadrit ligjor në fuqi, duke përjashtuar tarifat e studimit, dhënies së bursave sipas kategorive të caktuara dhe aktiviteteve të ndryshme sociale. Duke i ardhur kështu në ndihmë këtyre kategorive. <i>Evidenca 2.1 Vendimi i Bordit të Administrimi për bursat dhe përjashtimet.</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstatoi se institucioni ka hartuar politika të qarta që mbulojnë të gjitha aspektet që duhen për këtë cikël studimi, përfshi këtu kirteret hyrëse, kriteret e bursave dhe kriteret për informim të të gjithë të interesuarëve.</i>			
Shkalla e përbushjes së standardit		Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Procedurat e përparimit të studentit si dhe të kalimit nga një vit akademik në tjetrin janë të përcaktuara në Rregulloren e UNIEL. Vendimet janë të publikuara në faqen zyrtare të institucionit.</p> <p>Bazuar në RVB, por edhe nga takimet në institucion kontatojmë se sekretaria mësimore dhe sistemi EMS luajnë një rol të rëndësishëm në informimin e studentit për përparimin e tij akademik.</p> <p>Një rol të rëndësishëm për këtë kriter luan dhe Zyra e Këshillimit të studentëve dhe karrierës, e cila ka funksion informues të hollësishëm për studentin.</p> <p><i>Evidenca 1.2 Rregullore e studimeve të UNIEL</i> <i>Evidenca 1.7 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane</i> <i>Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit "Bachelor në gazetari"</i> <i>Evidenca 5.17 Rregullore për funksionimin e Komisionit të Përhershëm për studentët dhe Këshillimin e Karrierës</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Në rregulloren e programit të studimit dhe rregulloret e Departamentit të Letërsisë dhe Gazetarisë si dhe të FSHH përcaktohen procedurat dhe kriteret që ndiqen për transferimin e studentëve nga shkolla të tjera universitare</p> <p>vendase ose të huaja, publike ose jopublike, si dhe lejon transferimin e studentëve të UE në shkolla të tjera. Njohja e krediteve të fituara nga studimet e mëparshme bëhet nga Komisioni i posaçëm i Ekuivalentimit. Të gjitha këto ju bëhen me dije studentëve paraprakisht.</p> <p><i>Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit "Bachelor në gazetari"</i> <i>Evidenca 1.7 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane</i> <i>Evidenca 1.14 Rregullore e departamentit të letërsisë dhe gazetarisë</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se Kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve janë të përcaktuar në rregulloret e njësisë kryesore dhe asaj bazë, si edhe në syllabulls të cdo lënde. Programi u bëhet i ditur studentëve që orën e parë të mësimit, në këtë mënyrë ata njihen edhe me mënyrën e vlerësimit të tyre në cdo lëndë çdo fillim semestri nga pedagogu i lëndës respective.</p> <p><i>Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit "Bachelor në gazetari"</i> <i>Evidenca 1.14 Rregullore e departamentit të letërsisë dhe gazetarisë</i> <i>Evidenca 3.16 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit</i> <i>Tabela 15 Format e kontrollit të dijeve</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit përcaktohen në rregulloren e Universitetit, Rregulloren e FSHH, Departamentit të Letërsisë dhe Gazetarisë, dhe të programit përkatës të studimit. Institucioni ka hartuar edhe një manual mbi punimin e diplomës që u bëhet i njohur studentëve nga takimet me</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al


	<p>përgjegjës in e departamentit dhe pedagogët udhëheqës të tyre. Manuali gjendet edhe në faqen zyrtare të UE.</p> <p><i>Evidenca 1.2 Rregullore e studimeve të UNIEL</i> <i>Evidenca 3.10 Manuali i punimit të diplomës</i> <i>Evidenca 3.14 Paketa e punimit të diplomës për programin e studimit (Rregullorja e diplomimit)</i></p>			
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani, në fillim të çdo viti akademik organizon takime të hapura me të interesuarit për t’i informuar mbi programet e studimit që ofron ky institucion. Këto informacione përcillen edhe përmes panairove apo medias, si edhe përgatitjes së fletëpalosjes dhe posterave për të bërë publike programet e studimit të ofruara prej tij. Gjithashtu, UNIEL ka strukturë të dedikuar Zyrën e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni që merret me gjurmimin e studentëve dhe organizimin e ditëve të hapura për informimin e studentëve. UNIEL ka publikuar edhe një spot promovues për programet e studimit që ofron. Në takimet e organizuara marrin pjesë edhe pedagogët e njësisë bazë.</p> <p><i>Evidenca 5.2 Kalendari i ditëve të hapura 2022</i> <i>Evidenca 5.3 Publikimi i spotit promovues</i> <i>Evidenca 5.4 Fletëpalosjet promovuese</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se institucioni ka marrë masa të për të gjithë komunikimin me studentin përgjatë jetës së tij akademike. Sistemi EMS është tepër eficient për ruajtjen e rekordeve, por edhe për monitorimin individual të çdo studenti në lidhje me ecurinë e tij mësimore. Shumë udhëzues bëhen publike në faqen e UNIEL, por edhe në këndet e njoftimeve përkatëse. Studenti është gjithnjë i informuar edhe nëpërmjet emalit zyrtar të shkollës. GVJ konfirmon se UE e përmbush plotësisht këtë standart.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se studentët e marrin informacionin për strukturën dhe kohëzgjatjen e studimeve nga faqja zyrtare e UNIEL, por gjithashtu edhe nëpërmjet koordinators të programit të studimit.</p> <p><i>Evidenca 1.18 Strategjia e zhvillimit të programit të studimit “Bachelor në Gazetari”</i> <i>Evidenca 1.23 Përshkrimi I detyrave të koordinators të programit të studimit</i> <i>Evidenca 4.12 TË dhëna mbi publikimin në faqen e UEB</i></p>

<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>GVJ konstaton se studenti merr informacionet për lëndët dhe modulet nga dy mënyra. E para lidhet me sistemin EMS ku studenti ka akses dhe e dyta lidhet me publikimin në faqen zyrtare të UNIEL. Një rol të rëndësishëm luan dhe sekretaria mësimore. Studenti gjen informacion edhe në këndin e njoftimeve tek hollet e Universitetit.</p> <p><i>Evidenca 1.18 Strategjia e zhvillimit të programit të studimit "Bachelor në Gazetari"</i> <i>Evidenca 3.15 Plani mësimor i programit të studimit "Bachelor në gazetari"</i> <i>Evidenca 4.12 Të dhëna mbi publikim në faqen e UEB</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Bordi këshillimor i biznesit bën të mundur përfshirjen e studentëve në aktivitete të shumta për tu njohur me punëdhënës.</p> <p>Nga takimi me Zyrën e këshillimit të karrierës dhe Alumnin u informuam se janë pikërisht këto dy zyra që u japin studentëve informacion për mundësinë e punësimit. Gjithashtu, u informuam se studentëve me performancë të lartë gjatë praktikës në institucion u ofrohet dhe mundësi punësimi reale.</p> <p><i>Evidenca 3. 9 Lista e aktiviteteve të Bordit Këshillimor të Biznesit 2021-2022</i> <i>Evidenca 5.5 Të dhëna mbi studentët përfitues të programit të nxitjes së punësimit</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Orari mësimor, plani mësimor afishohen në ambjentet e FSHH, dhe studentët informohen mbi logjistikën dhe infrastrukturën e UE lidhur me mjediset që do përdoren nga ata gjatë studimeve, si klasat e leksioneve dhe seminareve, biblioteka, laboratorët etj.</p> <p>Departamenti i Letërsisë dhe Gazetarisë mbështetet edhe nga sekretaria mësimore, biblioteka dhe ZKSK.</p> <p><i>Evidenca 1.15 Modalitetet e organizimit dhe funksionimit të sekretarisë mësimore të FSHH</i> <i>Evidenca 4.6 Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e Fakultetit të Shkencave Humane</i></p>
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>UE kujdeset për Menaxhimi i Sistemit të Informacionit "EMS" i cili synon koordinimin e punës së stafit akademik me stafin administrativ dhe studentët. Nëpërmjet faqes zyrtare të UE, studentët mund të komunikojnë në distancë me pedagogët, ose të shikojnë të dhënat që ata kanë hedhur në këtë sistem. Gjatë vizitës në IAL dhe intervistave me stafin akademik por edhe GVB na u referua se çdo pedagog komunikon edhe në formë lektroike me studentët.</p> <p><i>Evidenca 4.11 Rregullorja e EMS</i> <i>Evidenca 4.12 Të dhëna mbi publikimin në faqen e UEB</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bazuar nga dokumentacioni, por edhe duke u konsuluar me faqen zyrtare të Universitetit është e qartë se studenti informohet për cdo gjë, që në fillim të studimeve dhe deri në përfundim. Një punë parapërgatitore për t'i ardhur në ndihmë studentëve është faza e</i></p>



	rekrutimeve, ku UNIEL u vjen në ndihmë studentëve për zgjedhjen e duhur. GVJ konfirmon se UNIEL e përmbush plotësisht këtë standart.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standarti V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.</p>	<p>UE mban një bazë të dhënash mbi numrin e studentëve të regjistruar dhe diplomuar në këtë program studimi. Në sekretarinë mësimore ruhet dokumentacioni i procesit mësimor. Nga punonjësit e Drejtorisë së Standarteve dhe Sigurimit të Cilësisë pranë rektoratit të UNIEL u vumë në dijeni se kjo zyrë mban statistika të plota në lidhje me numrin e të diplomuarëve në programin e studimit “Bachelor në Gazetarisë”. Edhe nga Zyra e këshillimit të karrierës dhe Alumnit u bëmë me dije se këto zyra asistojnë në gjurmimin e studentëve që përditësohet çdo vit.</p> <p><i>Evidenca 5.6 Të dhënat mbi punësimin e të diplomuarëve 2020-2021/2021-2022</i> <i>Tabela 23 Të dhëna për diplomimin dhe punësimine studentëve.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, por bazuar edhe në RVJ, u konstatua se Sekretaria mësimore mban dosjen personale të studentit, e cila krijohet nga momenti i regjistrimit dhe përditësohet gjatë gjithë jetës së tij studentore. Gjatë vizitës u kërkuan 2 dosje të dy studentëve, një e këtij viti akademik dhe një të një studentit të vitit të tretë. Në këtë dosje gjenden edhe informacione mbi praktikën dhe punimin e diplomës.</p> <p><i>Tabela 23 Të dhëna për diplomimin dhe punësimine studentëve.</i> <i>Evidenca 5.6 Të dhënat mbi punësimin e të diplomuarëve 2020-2021/2021-2022</i></p>
<p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>GVJ konstaton se të dhënat statistikore të studentëve në UNIEL menaxhohen nga dy struktura: Drejtoria e Standarteve të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe nga Drejtoria Ekonomike. Gjithashtu GVJ konstaton se Sekretaria Mësimore e FSHH është përgjegjësi për menaxhimin e procesit të regjistrimit të studentëve, transkriptin e studentit dhe çdo informacion që lidhet me aktivitetin mësimor të tij. Informacioni ruhet në mënyrë konfidenciale dhe shpërndahet vetëm tek palët e autorizuar sipar ligjeve dhe akteve nënligjore për Arsimin e Lartë dhe Rregulloret të UE.</p> <p><i>Evidenca 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL</i></p>

	<p><i>Evidenca 1.15 Modalitetet e organizimit dhe funksionimit të Sekretarisë mësimore të FSHH</i></p> <p><i>Evidenca 2.4 Rregullore për për ruajtjen, administrimin dhe arkivimin e dokumentacionit në UE.</i></p>		
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>Nëpërmjet RVB konstatohet se është Rektorati dhe drejtoritë përkatëse që kryejnë kontrole periodike pranë sekretarive mësimore dhe departamenteve. Këto kontrole lidhen me menaxhimin e informacioneve dhe dokumentacioneve, si dhe me vlerësimin e gjendjes dhe saktësisë së informacionit të ruajtur në këto zyra.</p> <p><i>Evidenca 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL</i></p> <p><i>Evidenca 1.15 Modalitetet e organizimit dhe funksionimit të Sekretarisë mësimore të FSHH</i></p> <p><i>Evidenca 2.4 Rregullore për për ruajtjen, administrimin dhe arkivimin e dokumentacionit në UE.</i></p>		
<p>Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>GVJ konstaton se njësia bazë harton në mënyrë periodike raporte për cilësinë e studentëve të programit të studimeve “Bachelor në gazetari”. Gjatë vizitës se GVJ në IAL na u vunë në dispozicion shembuj të këtyre raporteve.</p> <p><i>Evidenca 1.29 Raport mbi veprimtarinë e programit të studimit “Bachelor në gazetari për vitin akademik 2020-2021/ 2021-2022</i></p> <p><i>Evidenca 1.32 Analiza vjetor e departamentit të letërsisë dhe gazetarisë 2020-2021/2021-2022</i></p> <p><i>Evidenca 1.34 Politika e marketingut për programin e studimit “Bachelor në gazetari”</i></p> <p><i>Tabela 21- Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve</i></p> <p><i>Tabela 22-Aktivizimi I studentëve në aktivitete të njësisë në tre vitet e fundit.</i></p> <p><i>Tabela 23- Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve</i></p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore u evidentua qartë mirëmenaxhimi i të dhënave të studentëve në regjistrat përkatës sipas programeve të studimit. Institucioni ka marrë masa për ruajtjen e të dhënave të cdo studentit, të dhëna që lidhen me amzën, por edhe me ecurinë akademike. Për tu vlerësuar saktësia e ruajtjeve të të dhënave në Sekretari. GVJ konfirmon se UNIEL e përmbush plotësisht këtë standart.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p>X</p>

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>Bazuar në nenet 54 dhe 55 të ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë” si dhe statutit të UNIEL insitucioni duhet të angazhojë studentë dhe/ose përfaqësues të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese të UMSH.</p> <p>Sipas RVB-së, studentët në UE janë të organizuar zyrtarisht në Këshillin studentor dhe kanë rregulloren e organizimit dhe funksionimit të tyre. Në Senatit akademik të UNIEL marrin pjesë 2 senatorë. Studentët gëzojnë të drejtën për të qenë pjesë në:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Komisionin për garantimin e standarteve të cilësisë së institucionit dhe programeve të studimit të ngritur pranë UE 2. Komisioni për marrëdhëniet me studentët dhe këshillimin e karrierës 3. Komisioni për garantimin e standarteve të cilësisë të njësisë bazë dhe programeve të studimit 4. Komisioni për mbrojtjen e studentëve <p><i>Evidenca 2.2 Lista e anëtarëve të Senatit akademik UNIEL</i> <i>Evidenca 2.3 Rregullore e Këshillit studentor</i> <i>Tabela 24 – Të dhënat për anëtarët e NJSBC</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>GVJ konstaton se UNIEL garanton përfshirjen e studentëve në Senatit Akademik. Studentët janë të organizuar edhe në Këshillin studentor. Mendimi i studentëve merret në formë të drejtëpërdrejtë, por edhe nga kutia e ankesave.</p> <p><i>Evidenca 2.3 Rregullore e Këshillit studentor</i> <i>Evidenca 2.2 Lista e anëtarëve të senatit akademik UNIEL</i> <i>Evidenca 5.7 Vendimi për komisionin institucional zgjedhor</i> <i>Evidenca 5.8 Urdhëri për Komisionin e Vetëvlerësimit për Akreditimin Institucional</i> <i>Evidenca 5.9 Urdhëri për komisionet e përhershme në Fakultet</i> <i>Evidenca 5.12 Urdhëri për grupin e punës për raportin e vetëvlerësimit për programin MSHGJ</i> <i>Evidenca 5.14 Vendimi I Dekanit të FSHH për ngritjen e GVB 2022</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Sipas RVJ studentët komunikojnë me koordinatorin e programit të studimit për të gjitha problematikat që kanë gjatë gjithë jetës studentore. Gjithashtu koordinatori na konfirmon se është pikërisht ai që kujdeset që të marrë sygjerimet e studentëve për përmirësimin apo rishikimin e programit mësimor dhe shërben si pikë kontakti midis tyre dhe departamentit.</p> <p><i>Evidenca 1.7 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane</i> <i>Evidenca 1.18 Strategjia e zhvillimit të programit të studimit “Bachelor në Gazetari”</i> <i>Evidenca 3.13 Informacion për politikën e zhvillimit dhe të përmirësimit të kurrikulave</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së</p>	<p>Nga RVB dhe nga takimi me studentët GVJ konstaton se student, në rast se është i pakënaqur me rezultatin për një vlerësim të caktuar paraqet kërkesën e tij tek drejtuesi i njësisë bazë. Ky i fundit kërkon ngritjen e një komisioni rivlerësimi. Komisioni i rivlerësimit merr vendim pas</p>

procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultetit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	<p>rishqyrtimit. GVB na konfirmoi se vendimi i këtij komisioni është i formës së prerë dhe nuk kthehet më. Ky vendim përcillet në sekretari, e cila bën dhe njoftimin për studentin.</p> <p><i>Evidenca 1.2 Rregullore e studimeve të UNIEL</i> <i>Evidenca 1.7 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane</i> <i>Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit</i></p>		
Konkluzione	<p><i>Organizimi i këshillit studentor, por edhe përfshirja e një studenti në komisione të ndryshme, e vërteton më së miri faktin që Institucioni merr masa për dëgjimin e zërit të studentit. Studenti në cdo kohë mund të japë mendimin e tij në lidhje me procesin mësimor, duke shfrytëzuar përfaqësimin në Këshill studentor por edhe në këto komisionie të posacme. GVJ konfirmon ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X


Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	<p>GVJ konstaton se UNIEL ka njësi të posaçme të informimit në shërbim të studentëve: Sekretaria mësimore, Zyra e Financës, Zyra e IT, Zyra e kurrikulave, Zyra e marrëdhënieve me jashtë, Zyra e këshillimit të Karrierës dhe Alumni. Gjatë takimit me studentët, GVJ i pyeti nëse i njihnin këto zyra dhe pse paraqiteshin tek ato. Studentët u përgjigjën që i njihnin dhe se paraqiteshin tek këto zyra sipas rastit dhe nevojës.</p> <p><i>Evidenca 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit të UNIEL</i> <i>Evidenca 5.16 Rregullore për funksionimin e Komisionit të Përherëshëm për studentët dhe këshillimin e karrierës.</i></p>
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	<p>Sipas RVB, është zyra e këshillimit të karrierës dhe ALUMNI ajo njësi që ka detyrë funksionale informimin dhe ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre edhe për tregun e punës. Gjatë takimit me këtë zyrë GVJ u informua më në detaje për këtë proces që mbulon kjo zyrë. Gjithashtu, edhe Drejtoria e Standarteve dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë ndihmon në dhënien e ekspertizës për përmirësimin e procesit mësimor dhe për programet e studimit.</p> <p><i>Evidenca 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit të UNIEL</i> <i>Evidenca 5.16 Rregullore për funksionimin e Komisionit të Përhershëm për studentët dhe këshillimin e karrierës.</i></p>
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në	<p>Shërbimi i këshillimit të karrierës në UNIEL mbulohet nga Njësia e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI. Kjo njësi funksionon sipas përcaktimeve në Statutin e UNIEL. Gjithshtu kjo njësi jep mbështetjen e saj për informacion të saktë në lidhje me zgjedhjen dhe orientimin e duhur</p>

<p>mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>të studentit përgjatë procesit mësimor, si dhe zgjedhjen dhe orientimin e duhur për praktikën profesionale apo orientimin e saktë në tregun e punës.</p> <p><i>Evidenca 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit të UNIEL</i> <i>Evidenca 5.16 Rregullore për funksionimin e Komisionit të Përherëshëm për studentët dhe këshillimin e karrierës.</i></p>			
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Sipas RVB, Njësia e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI ka krijuar një database të të dhënave dhe gjurmimit të studentëve, e cila përditësohet me të dhënat çdo vit.</p> <p>Sipas anëtarëve të kësaj njësie, gjurmimi i studentëve ndihmon departamentet që të kuptojnë se ku janë punësuar studentët e programeve të studimit që ata ofrojnë, por edhe për të rritur bashkëpunimin e tyre me studentët në auditor për integrimin në tregun e punës.</p> <p><i>Evidenca 5.16 Rregullore për funksionimin e Komisionit të Përherëshëm për studentët dhe këshillimin e karrierës.</i> <i>Evidenca 5.6 Të dhëna mbi punësimin e të diplomuarëve 2020-2021/2021-2022</i> <i>Tabela 23- Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve.</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Nisur nga dokumentacioni i dorëzuar nga GVB, por edhe nga takimet me studentët dhe Zyrën e Këshillimit të studentëve dhe Karrierës, GVJ konstaton se kjo zyrë është gjithnjë në dispozicion të studentëve që në hyrje dhe deri në diplomim. Madje për tu vlerësuar edhe Zyra Alumni, e cila është tepër aktive me ndjekjen e studentëve në tregun e punës. GVJ konfirmon se UNIEL e përmbush plotësisht këtë standart.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardevë të fushës V</p>	<p>Plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>
--	--------------------------	-------------------------------------	------------------------------------	--



VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Bazuar në dokumentacionet e dorëzuara nga IAL dhe takimet me drejtuesit, punonjësit, dhe studentët e UNIEL, konstatohet se IAL ka zbatuar detyrimin për të ngritur Komisionin e Sigurimit të Cilësisë, sipas Ligjit të Arsimit të Lartë Nr. 80/2015, Statutit dhe Rregullores organizative të këtij institucioni.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Referuar <i>Nenit 71/ Kreu X i Statutit të Universitetit si dhe nenit 36/ Kreu VI të Rregullores së Organizimit dhe Funksionimit të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", datë 12.04. 2020</i> konstatohet se strukturat përgjegjëse NJSBC dhe KSBC organizojnë vetëm vlerësimet periodike të pyetësorëve në rang institucional. Gjatë takimit u vumë në dijeni që nga këto njësi nuk bëhet monitorim i programeve të lëndëve për të monitoruar nëse është respektuar VKM 41 për formatin e syllabusit të lëndës. Në fakt gjatë monitorimit të GVJ rezultoi se në evidencat e paraqitura, në disa syllabuse nuk përfshihet numri i faqeve të literaturës së detyrueshme dhe të rekomanduar për temat e lëndës. Nisur nga kjo rrethanë, është e qartë që nuk zhvillohet monitorim nga ana e këtyre njësive. <i>Mungesa e një njësie në nivel institucional për përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies mbetet një nga pikat e dobta të rëndësishme për këtë program studimi.</i>
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	Bazuar në Rregulloren organizative, si dhe gjatë takimeve me studentët vihet re qartë se ata përfshihen në vlerësimin periodik të mësimdhënies. Në organizimin e KJSBC është përfshirë një student (gjithësej 7 anëtarë, ku një është student). <i>Evidence 4.19, Evidenca 6.2, Evidenca 5.15</i>
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Në lidhje me monitorimin dhe sigurimin e Cilësisë njësi përgjegjëse pohon se rezultatet e pyetësorëve janë bërë publike së fundmi.
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmeve të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Në RVB theksohet se nuk ka dijeni për promovimin e shembujve të mirë dhe nuk gjenden nxitje të personelit akademik. Kjo gjë na u konfirmua edhe gjatë takimit me GVB në institucion. <i>Formalizimi i procedurave për ruajtjen e cilësisë dhe monitorimin e tyre mbetet një nga pikat e dobta kryesore për Departamentin e Letërsisë dhe Gazetarisë në programin "Bachelor në Gazetari". Fakti që ekziston një bashkëpunim i ngushtë midis stafit dhe studentëve nuk justifikon</i>

	<p><i>mungesën e formalizimit të mbarëvajtjes së jetës studentore dhe disa proceseve të rëndësishme mësimore.</i></p> <p><i>Mos vlerësimi i performancës së stafit akademik, dhe lëndëve konkrete nga studentët, apo moszhvillimi siç duhet i standarteve të cilësisë që të zbresin deri në nivel pedagogu/lënde, mbetet një pikë e dobët për këtë program. Aktualisht ky vlerësim kryhet më së shumti përmes pyetësorëve periodik në rang institucional.</i></p>		
Konkluzione	<p><i>Theksojme se Institucioni duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë sigurimit të brendshëm të cilësisë publikimit të rezultateve dhe praktikave të mira, për të garantuar që veprimtaria e tij jo vetëm të jetë në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi, të Statutit dhe të akteve të tjera të brendshme rregullatore, por gjithashtu që objektivat strategjike në përputhje me vizionin dhe misionin e institucionit të vazhdojnë të qëndrojnë në themel dhe të drejtojnë punën e përditshme të strukturave drejtuese dhe personelit. Praktikrat e mira janë motiv për ruajtjen dhe përmirësimin e standarteve.</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Institucioni ka të ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në formën e një njësie të përhershme në strukturën organizative të institucionit. NJSBC vlerëson periodikisht efikasitetin e veprimtarive mësimore e kërkimore, të UNIEL. Ai ka akses në të gjitha të dhënat e institucionit. Politikë parësore për sigurimin e cilësisë ka Raportin e pyetësorit të studentëve. Mbetet disi e paqartë edhe detyra funksionale e kësaj njësie, pasi edhe në evidencën 5.15 Rregullore e NJSBC të dorëzuar nga GVB, brenda është rregullore e Komisionit të përhershëm të standarteve dhe cilësisë.</p> <p><i>Evidenca 6.2 Publikimi i raportit 2021-2022</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>NJSBC ka përfshirë ekspertë të jashtëm, të cilët kanë sjellë këndvështrimet e reja për probleme të ndryshme, eksperiencia pozitive dhe praktika të përparuara, por vetëm nga procesi i akreditimit institucional që UNIEL e ka kaluar 2 herë. Meqënëse është hera e parë e akreditimit të këtij programi, nuk ka ende evidenca të akreditimeve të mëparshme. Është pak e paqartë nëse ka pjesëmarrje të ekspertëve të jashtëm përveç vlerësuesëve të akreditimeve. Nga GVB na u konfirmua se deri tani nuk ka pasur ekspertë të jashtëm përveç atyre të akreditimeve të deritanishme për programet e tjera të studimit.</p> <p><i>Evidenca 1.6 Evidenca 6.6</i></p>

<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>Veprimtaria e NJSBC është e rregulluar bazuar në:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ligjin e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, Nr.80/2015; Date 22.07.2015; Neni 103 dhe 104. • Statutin e Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” • Dokumenta të ASCAL-it <p>UE ka kaluar dy akreditime institucionale. Akreditimi ka qenë 6 vite në të dy herët.</p> <p>https://www.uniel.edu.al/universiteti-ue/analiza-dhe-raporte</p>		
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>Njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë vlerëson periodikisht rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore–shkencore të Universitetit dhe harton raportet përkatëse të Vlerësimit të Brendshëm. Këto raporte diskutohen në të gjitha njësitë e UE, me synim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në kryerjen e këtyre veprimtarive në të ardhmen. Vetë fakulteti dhe departamenti ndjek me përgjegjësi problemet që lidhen me ecurinë e procesit mësimor për këtë program studimi.</p> <p>GVJ i sugjeron NJSBC që rekomandimet e ekspertëve të jashtëm t’i përfshijë në një plan pune vjetor dhe të bëjë propozimet përkatëse për rritjen e standartit dhe cilësisë.</p> <p>Në evidenca të RVB dhe dokumentacionin e konsultuar është renditur vetëm <i>evidenca 3.14 “Korniza konceptuale e programit të studimit “Bachelor në gazetari” si “Procedure e ndjekur për përmirësimin e kurrikulës së programit.</i></p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Standarti përmbushet kryesisht. Ekspertët e jashtëm të këtij programi studimi nuk mund të mbeten vetëm vlerësuesit e akreditimeve, por edhe ekspertë të fushës së gazetarisë, të cilët mund të japin kontributin e tyre specifikisht për këtë program.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		X	

<p>Standardi VI.3 Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon</p>	<p>Gjatë takimit me drejtuesin e njësisë bazë që adminstron programin e studimit “Bachelor në gazetari” u njohëm me procedurat që ndjek departamenti për të monitoruar cilësinë e programit.</p> <p>Kyresisht: performancën që duhet të ketë stafi akademik gjatë mësimdhënies dhe pyetësorët e studentëve që zhvillohen periodikisht.</p> <p>Por gjatë takimit me pedagogët dhe anëtarët e NJSBC na u konfirmua që vlerësimi i studentëve nuk bëhet në rang departamenti, por në rang instiucional. Nga GVB dhe nga pedagogët e këtij departamenti u informuam se nuk e kanë praktikë vlerësimin e studentëve për lëndët që</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>ndjekin përgjatë dy semestrave. Vlerësimin e marrin nga studentët vetëm gojarisht gjatë takimeve në orët e mësimi.</p> <p>Raportimet e departamentit për monitorimet bëhen në fundvit. Materialet shërbejnë për vlerësimin e brendshëm institucional.</p> <p><i>Evidenca 1.9 Raport për veprimtarinë e programit të studimit "Bachelor në gazetari" për vitin 2020-2021; 2021-2022</i></p> <p><i>Evidenca 1.32 Analiza vjetore e departamentit të letërsisë dhe gazetarisë 2020-2021; 2021-2022</i></p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Departamenti i Letërsisë dhe Gazetarisë përcjell në dekanat analizën vjetore, duke e bërë kështu pjesë të analizës së fakultetit. Gjatë bisedës me drejtuesen e njësisë bazë dhe anëtarët e NJSBC u vumë në dijeni, se është duke u punuar për një mënyrë vlerësimi të pedagogut dhe lëndës nga studentët në mënyrë që ky departament të ketë një njësi matëse dhe vlerësimi. Nga takimi me drejtuesen e njësisë bazë kuptohet që ka një bashkëpunim të mirë mes departamentit dhe dekanatit. Kjo gjë është e qartë edhe nga dokumentacioni i dorëzuar, por mbetet i paqartë bashkëpunimi mes departamentit dhe NJSBC për vlerësimin e proceseve të tjera mësimore në shërbim të performancës së pedagogëve, vlerësimit të lëndëve dhe kurrikulës së këtij programi.</p> <p><i>Evidenca 1.9 Raport për veprimtarinë e programit të studimit "Bachelor në gazetari" për vitin 2020-2021; 2021-2022</i></p> <p><i>Evidenca 1.32 Analiza vjetore e departamentit të letërsisë dhe gazetarisë 2020-2021; 2021-2022</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Grupit të vlerësimit të brendshëm iu kërkua një shembull për monitorimin e procesit mësimor. Gjatë RVJ-së duket se është anashkaluar disi evidentimi i saktë i proceseve që kryen NJSBC.</p> <p>GVJ u bë me dijes se çdo fillim viti departamenti shqyrton programet lëndore për të kuptuar cilat do të jenë sygjyerimet e vlefshme për përmirësimin e tyre.</p> <p>Shkëmbimet e stafit vendas dhe të huaj ndihmojnë që programet të jenë të sipas standarteve ndërkombëtare</p> <p>Kreditet e fituara nga studentët që kanë zhvilluar një semestër në vendet partnere të programit ERASMUS + të mund të ekuivalentohen.</p> <p><i>Evidence 3.2 Të dhëna për mobilitetet</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të</p>	<p>Sipas RVB Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" zhvillon pyetësorët për matjen e performacës. Zyra e këshillimit përpunon</p>

<p>realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>pyetësorët. Departamenti i Letërsisë dhe Gazetarisë nuk e ka ende të hartuar një pyetësor që lidhet specifikisht me këtë program studimi. Në raportin e Grupit të vlerësuesëve të brendshëm nuk përmenden raporte nga intervista apo sondazhe të sektorëve publik dhe privat.</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Syngjerohet që disa nga monitorimet dhe raportimet e procesit mësimor nuk mund të mbeten vetëm në fund të vitit. Masat për përmirësim të proceseve, mund të merren edhe përgjatë vitit.</i></p> <p><i>GVJ sygjeron që IAL të shtojë metodat që rrisin qëndrueshmërinë dhe cilësinë e programit të studimit. Intervistat me punëdhënësit e këtij programi do të mund t'i shërbenin përmirësimit të kurrikulës. Sa më pranë tregut të punës të jetë departamenti, aq më të përgatitur për profesionin e nesërm studentët.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		X	

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ka parashikuar garantimin në politikat e cilësisë duke përfshirë të gjitha njësitë. Janë këto njësi që planifikojnë dhe organizojnë zbatimin dhe realizimin e sigurisë së cilësisë. Në raportin e GVB ka të evidentuar vetëm Statutin e Universitetit si evidencë. Nuk janë pasqyruar evidenca konkrete, ose shembull procedure.</p> <p><i>Evidenca 1.1 Statuti I UNIEL, Kreu X, neni 71, Kreu XII, neni 72, pika 9.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të</p>	<p>Bazuar në Rregulloren e Organizimit dhe Funkcionimit të Universitetit, detyrat dhe përgjegjësitë e njësive dhe individëve në lidhje me sigurimin e cilësisë janë të shprehura. Gjatë takimit me anëtarët e NJSBC, GVJ u përmendi atyre detyrat e NJSBC (Neni 18 Funkcionet dhe kompetencat e</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al


E-mail: info@asc.al

<p>tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>NJSBC/ pika 4 NJSBC monitoron duke ofruar udhëzime, duke mbledhur informacione dhe duke evidentuar probleme të cilat i përcjell në njësitë përgjegjëse për zgjidhje). Anëtarët u përgjigjën se deri tani kanë dhënë kontribut vetëm Raportin periodik të pyetësorëve në rang institucional.</p> <p><i>Evidenca 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL.</i> <i>Evidenca 6.7 Rregullore për funksionimin e Komisionit të Përhershëm për Standartet e Cilësisë.</i></p>		
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohej përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.</p>	<p>Nisur nga RVJ por edhe nga takimi me drejtuesen e departamentit u konfirmua se ky program studimi nuk u është nënshtruar akreditimeve të mëparshme, por është pikërisht ky departament që ka dhënë kontributin parësor për krijimin, hartimin dhe organizimin e programit të studimit “Bachelor në Gazetari”.</p> <p><i>Evidenca 5.14 Vendimi i Dekanit të FSHH-së për ngritjen e GVB 2022</i></p>		
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>GVJ konstaton se në përbërjen e GVB të miratuar me vendim të Dekanit janë përfshirë persona që janë anëtarë të Departamentit të Letërsisë dhe Gazetarisë, përfshi këtu pedagogët dhe student (kryetaren e këshillit studentor). Garantimin e integritetit akademik si dhe shmangien e diskriminimit apo pabarazisë e dëshmojnë edhe Rregullorja, për funksionimin e Komisionit të Përhershëm për Standartet e Cilësisë por edhe Kodi i Etikës në përdorim.</p> <p><i>Evidenca 6.5 Kodi i etikës UNIEL Evidenca 6.7. Rregullore për funksionimin e Komisionit të Përhershëm për Standartet e Cilësisë.</i></p>		
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Sikurse është shprehur edhe vetë GVJ në raport, por edhe gjatë vizitës në institucion në vlerësimin e programeve të studimit dhe në akreditimin institucional nuk janë përfshirë ende ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit, të cilët mund të japin mendimin e tyre.</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ është i mendimit se ekspertët e vlerësimit të jashtëm duhet të jenë të pranishëm me mendimet e tyre që në krijimin e programit dhe përgjatë, jo vetëm në fazë vlerësimi apo akreditimi. IAL mund të shfrytëzojë të gjitha bashkëpunimet me aktorë të jashtëm sipas marrëveshjeve apo bashkëpunimeve që tashmë ka.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		X	

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>GVJ ka konstatuar se UNIEL i bën publike pyetësorët institucional të studentëve. Në faqen zyrtare të UNIEL, në UEB gjenden raportet e pyetësorëve të dy viteve të fundit akademik. <i>Evidenca 6.2. Publikimi i Raportit 2021-2022.</i> <i>Evidenca 6.6 Raporti i vetëvlerësimit të brendshëm për akreditimin institucional</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” ka të publikuar rezultatet e pyetësorëve institucionalë në faqen zyrtare të tij për dy vitet e fundit akademik. <i>https://www.uniel.edu.al/universiteti-ue/analiza-dhe-raporte</i></p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>GVB ka deklaruar në Raport se rezultatet e vlerësimeve të procesit të akreditimit dhe rekomandimet e vlerësuesëve të jashtëm raportohen në rektorat. Në evidenca raportohet vetëm evidence 6.2 që lidhet vetëm me raportin e pyetësorit të studentëve. <i>Evidenca 6.2. Publikimi i Raportit 2021-2022. Evidenca 6.6 Raporti i vetëvlerësimit të brendshëm për akreditimin institucional</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Nisur nga takimet me grupet përkatëse, por edhe nga vetë raporti i GVB është e qartë që Institucioni i jep përparësi veprimtarive akademike, mësimore dhe shkencore që kanë lidhje me rritjen e cilësisë së programit të studimit. Nga raporti i GVJ-së përsëritet vazhdimisht si evidencë, pothuajse për të gjitha pikat evidence 6.2. e cila ka të bëjë me pyetësorin. GVJ sugjeron që në këtë kriter të përfshihet edhe efektiviteti i veprimtarive që organizon vetë departamenti, si leksione të hapura apo aktivitete të tjera që ndihmojnë në rritjen e cilësisë së programit.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Nga RVB dhe takimet gjatë vizitës në institucion bëhet i qartë fakti që UNIEL investon në sigurimin e cilësisë nëpërmjet trajnimeve të pedagogëve për metodikën e mësimdhënies dhe rregulloren e brendshme të institucionit në të gjitha ciklet e studimit, por si evidencë vendoset sërisht vetëm evidence 6.2 <i>Publikimi i raportit 2021-2022.</i> Në plotësimin e këtij kriteri nga GVB përmendet pjesmarrja në veprimtari kërkimore shkencore të studentëve, takimet dhe trajnimet, por nuk ka evidencë të qartë që lidhet me këto veprimtari sidomos për departamentin e letërsisë dhe gazetarisë.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se standarti plotësohet kryesisht. Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, janë publike, transparente. Në të gjitha kriteret është vendosur vetëm evidence 6.2. Nuk ka evidencë për planin e masave apo për organizimin e trajnimeve. GVJ sugjeron që sigurimi i cilësisë të mos mbetet vetëm tek evidence 6.2, Publikimi i raportit.</i></p>




Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardevë të fushës VI		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al




Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Bachelor në Gazetari” të ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Departamenti i Letërsisë dhe gazetarisë, pranë FSHH, UNIEL, ka angazhuar në programin “Bachelor në Gazetari” një trupe akademike që gëzon nivele të larta profesionale, sa nga aspekti akademik, po aq edhe nga aspekti profesional. Pjesëtarët e stafit akademik dhe administrativ shfaqin një nivel të lartë bashkëpunimi midis tyre dhe me studentët, në interesin e këtyre të fundit.
2. Institucioni ka angazhuar gjithashtu edhe personel me kohë të pjesshme, ekspertë të fushës varësisht lëndëve/moduleve që mbulojnë, më së shumti kur fokusi është në zhvillimin profesional të studentëve.
3. UNIEL ka disa marrëveshje funksionale që u mundëson anëtarëve të personelit akademik, por edhe studentëve, konkretisht të programit “Bachelor në Gazetari” mundësi mobiliteti në universitete jashtë vendit.
4. Një pikë e lavdërueshme është edhe gërshetimi që i bëhet teorisë me praktikën, jo vetëm brenda kurrikulës së programit “Bachelor në Gazetari”, por edhe përmes programeve jashtë-kurrikulare, ku falë numrit jo të lartë të studentëve dhe disponueshmërisë së stafit akademik në çdo moment, studentët gjejnë mundësi të shumta praktike profesionale dhe mbështetje për formimin e tyre shumë-dimensional.
5. Biblioteka e pasur tradicionale dhe ajo online është një pikë e rëndësishme që UNIEL ka vënë në funksion të personelit akademik dhe studentëve, në rastin konkret për programin “Bachelor në Gazetari”.

Pika të dobta:


1. Formalizimi i procedurave për ruajtjen e cilësisë dhe monitorimin e tyre mbetet një nga pikat e dobta kryesore për Departamentin e Letërsisë dhe Gazetarisë në programin “Bachelor në Gazetari”. Fakti që ekziston një bashkëpunim i ngushtë midis stafit dhe studentëve nuk justifikon mungesën e formalizimit të mbarëvajtjes së jetës studentore dhe disa proceseve të rëndësishme mësimore. (Standardi VI.1, kriteri 5)
2. Mos vlerësimi i performancës së stafit akademik, dhe lëndëve konkrete nga studentët, apo moszhvillimi siç duhet i shtandarteve të cilësisë që të zbresin deri në nivel pedagogu/lënde, mbetet një pikë e dobët për këtë program. Aktualisht ky vlerësim kryhet më së shumti përmes pyetësorëve periodik në rang institucional. (Standardi VI.1, kriteri 5)
3. Laboratori i Mediatikës ende nuk përmbush nevojat e programit të studimit. Ky laborator, paçka se ka pajisje të mjaftueshme në numër, ato nuk u përgjigjen dinamikave të zhvillimeve të fushës. (Standardi IV.2, kriteri 4)



4. Mungesa e një njësie në nivel institucional për përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies mbetet një nga pikat e dobta të rëndësishme për këtë program. (Standardi VI.1, kriteri 2)

Rekomandime:

1. GVJ rekomandon që Komisioni i përhershëm për garantimin e cilësisë dhe NJSBC të mirëpërcaktojnë ndarjen e detyrave mes tyre nëpërmjet rregulloreve të veçanta për secilën nga njësitë dhe ta zgjerojnë aktivitetin e tyre në lidhje me funksionet e kompetencave për sigurimin e cilësisë në UNIEL, duke mos mbetur vetëm tek pyetësi periodik i studentëve në rang institucional.
2. Bazuar në detyrat dhe funksionet e tyre sipas Statutit dhe Rregullores së UNIEL, Komisioni i përhershëm i cilësisë dhe Njësia e sigurimit të cilësisë, të punojnë për formalizimin e procedurave të sigurimit të cilësisë. Formalizimi mund të jetë në rang institucional, por cdo njësi kryesore apo njësi bazë të ketë detyrimin për t'i ndjekur dhe të mundësojë aksesimin e këtyre dy njësive për t'i monitoruar sipas një planveprimi pune të caktuar në fillim të vitit akademik.
3. NJSBC të formalizojë instrumentët vlerësues dhe monitorues që t'i shërbejnë ruajtjes së cilësisë në nivel intitucional, në nivel njësie kryesore dhe në nivel të njësive bazë. Tërheqja e mendimit të studentëve dhe përfshirja e tyre në vlerësim për lëndën, pedagogun, stafin administrative mbështetës, zyra të shërbimeve etj., duhet të jetë një ndihmë për përmirësimin e standardeve, për matjen e performancës së pedagogëve në fund të vitit si dhe ndihmë për plotësimin në mënyrë efektive të analizës vjetore të departamentit dhe fakultetit si dhe për përmirësimin apo ruajtjen e cilësisë së programit.
4. Komisioni i përhershëm i cilësisë dhe NJSBC në bashkëpunim me njësinë bazë të hartojë një planveprim monitorimi vjetor për monitorimin e zhvillimit të orës mësimore, për respektimin e formateve të gjithë procedurave që lidhen me mbarëvajtjen e procesit mësimor (syllabus, teza provimi, ruajtjen procesverbalet e mbledhjeve të hapura me studentët). Në këtë mënyrë, këto njësi do të ndikojnë në përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies.
5. Faqja e zyrtare e UNIEL nuk duhet të jetë vetëm në gjuhën shqipe, por edhe në atë angleze.
6. IAL mund të shfrytëzojë të gjitha bashkëpunimet me aktorë të jashtëm sipas marrëveshjeve apo bashkëpunimeve që tashmë ka për të ftuar ekspertë të jashtëm, ekspertiza e të cilëve do të ishte e vlefshme për rritjen e cilësisë, por edhe për afrimin sa më pranë të programit me tregun e punës.




Evaluation's conclusions for the first cycle study program Bachelor in "Journalism" provided by the Higher Education Institution "University of Elbasan Aleksandër Xhuvani"

Strengths and Affirmations:

1. The Department of Literature and Journalism at Faculty of Human Sciences (FHS), University of Elbasan (UE), has engaged in the "Bachelor in Journalism" program an academic group with high professional and academic levels. Members of the academic and administrative staff display a high level of cooperation with one another and their students as well, in the interest of the latter.
2. The institution has also engaged part-time personnel, experts in the field based on the subjects/modules they cover, since the focus is on the professional development of students.
3. 3. UE has assigned several functional agreements with universities abroad that provide mobility opportunities for its academic staff and students, specifically those of the "Bachelor in Journalism" program, to grow professionally and academically in the framework of their studies.
4. 4. A commendable point is the combining of theory with practice not only within the curriculum of the "Bachelor in Journalism" program, but also through extra-curricular programs, where thanks to the not high number of students and the availability of academic staff in each moment, students find numerous professional practice opportunities and support for their multi-dimensional formation.
5. 5. The rich traditional and online library is one of the strongest point of UE, which is available to the academic staff and students.

Weak points:


1. The formalization of procedures for maintaining its quality and their monitoring remains one of the main weak points for the Department of Literature and Journalism in the "Bachelor in Journalism" program. Even though there is close cooperation between the academic staff and the students, it does not justify the lack of formalization of the smooth running of student life and of some important learning processes. *(Standard VI.1, criteria 5)*
2. The failure to evaluate the performance of the academic staff and of concrete subjects by students, or to properly develop quality standards according to the level of the lecturer/subject, remains a weak point for this program. Currently, this assessment is mostly carried out through periodic questionnaires at the institutional level. *(Standard VI.1, criteria 5)*
3. The Mediatics Laboratory still does not meet the needs of this study program. Although this laboratory has enough equipment, they do not respond to the dynamics of developments in this field. *(Standard IV.2, criteria 4)*



4. The lack of a unit at the institutional level for the continuous improvement of teaching remains one of the important weak points of this study program. (*Standard VI.1, criteria 2*)

Recommendations:

1. EEG (External Evaluation Group) recommends that the Permanent Commission for Quality Assurance and Internal Quality Assurance Unit (IQAU) define the division of duties between them through separate regulations for each of the units, and expand their activity in relation to the functions of competences for quality assurance at UE, not only limited in the periodic questionnaire of students.
2. Based on their duties and functions, according to the Statute and Regulation of UE, the Permanent Commission for Quality Assurance and Internal Quality Assurance Unit (IQAU) have to work for the formalization of the quality assurance procedures. The formalization can be at the institutional level, and each unit has the obligation to follow and enable the access of these two units to monitor them according to a specific work plan at the beginning of the academic year.
3. IQAU have to formalize the evaluation and monitoring instruments for the preservation of quality at the institutional level, at the main and basic unit level. Attracting the opinion of students and involving them in the evaluation of the subject, lecturer, administrative support staff, service offices, etc., help in the improvement of the standards, of measuring the performance of the lecturers at the end of the academic year, of effectively completing the annual review of the department and faculty, and of improving and maintaining the quality of the program as well.
4. the Permanent Commission for Quality Assurance and Internal Quality Assurance Unit (IQAU) in cooperation with the basic unit have to draw an annual monitoring action plan for monitoring the development of the lesson, for respecting the formats of all procedures related to the smooth running of the teaching process (syllabus, exam theses, and record keeping of open meetings with students). In this way, these units will affect the continuous improvement of teaching.
5. The official website of UE has to be in English as well.
6. HEI can use all its collaborations, its existing agreements and collaborations, with external actors to invite external experts, whose expertise would be valuable for increasing the quality of this program, and to bring it as close as possible to the Labor market as well.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
		Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR			X	
VLERËSIMI TËRËSOR				X